

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5948
E shtunë, 7 dhjetor 2019
çmimi 0.40 €

BQK-ja mbyll
'IuteCreditKosovo'
dhe 'Monego'-n IFAQE 9



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

Recension nga Bedri TAHIRI

NJË VEPËR ME VLERA PËR THEMELTARËT E ALBANOLOGJISË F. 5

(Hazir MEHMETI, "STUDIUES
AUSTRIAKË E SHQIPTARË NË
AUSTRI - Në gjuhë, art dhe kulturë",
Lena, Prishtinë, 2019



Mr. sci. Hazir MEHMETI

AKTUALE

SHQIPËRIA MERR PRESIDENCËN E OSBE-së F. 2

KDI-ja: VAZHDIMI I DIALOGUT NUK DUHET TA GJEJË KOSOVËN PA KONSENSUS TË BRENDSHËM F. 7

AVOKATI GASHI BËN KALLËZIM PENAL KUNDËR ALEKSANDËR VUÇIQT F. 6

EKONOMI

KEK-U KA BËRË PËRGATITJET E NEVOJSHME PËR SEZONIN DIMËROR F. 9

KULTURË

'VDEKJA MË VJEN PREJ SYVE TË TILLË' E REXHEP QOSJES EDHE NË GJUHËN ITALIANE F. 15

THEMELOHET ÇMIMI LETRAR 'ADEM DEMAÇI' F. 15

ANALISTËT POLITIKË TREGOJNË SE SI LËVIZJA VETËVENDOSJE DHE
LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS MUND TA TEJKALOJNË ÇËSHTJEN E
POSTIT TË PRESIDENTIT TË ARDHSHËM IFAQE 4-5

ANALISTËT: ZGJEDHJA E PRESIDENTIT NGA QYTETARËT TEJKALON NGËRÇËT POLITIKE

Njohësit e rrethanave politike dhe kushtetuese në vend kanë bërë me dije se Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) duhet të bëjnë një kompromis për çështjen e presidentit në mënyrë që sa më shpejt të vijë deri te një mar-

rëveshje për bashkëqeverisje. Mazllum Baraliu dhe Ismet Kryeziu kanë vlerësuar se LV-ja dhe LDK-ja duhet të pajtohen që zgjedhja e presidentit të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët ose të gjejnë një kandidat konsensual për këtë post



Dërgimi i Ligjit për paga në Kushtetuese sjell pakënaqësi te punëtorët e sektorit publik

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK), Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSShK) dhe Sindikata e Policisë së Kosovës (PSK) kanë kërkuar të premten takim urgjent me përfaqësuesit kryesorë të shtetit pas dërgimit të Ligjit për paga në Gjykatën Kushtetuese nga Avokati i Popullit.

"Ky takim kërkohet me qëllim të informimit nga ana e tri sindikatave për pasojat e mundshme në rast të mosimplementimit të Ligjit për paga. Takimi duhet të mbahet më së largu deri të martën", është thënë në deklaratën e përbashkët të këtyre tri sindikatave IFAQE 3



Thaçi: BE-ja, standarde të dyfishta, shtetet bashkëpunuese po i bllokun, shtetet shantazhuese po i shpërblen F. 5



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Macroni: Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut nuk janë gati për negociata

PARIS, 6 DHJETOR - Presidenti francez Emmanuel Macron përsëriti në Londër qëndrimin e Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut nuk janë gati për nisjen e negociatave me BE. Ai sfidon strategjinë e presionit publik evropian ndaj tij.

Fillimisht, menjëherë pas jo-së së parë të Macronit pasoi rezoluta e Parlamentit Evropian, e cila kërkon nisjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Pastaj kryetarja gjermane e Komisionit të ri Evropian, Ursula von der Leyen u shpreh në krye të mandatit se do të këmbëngulë, që "ndryshimet procedurale, të kërkuara nga Franca, të bëhen

gradualisht, dhe që shteteve t'u jepet mundësia të nisin negociatat e anëtarësimit".

Argumenti gjeopolitik u përsërit këtë javë nga ministrja gjermane e Mbrojtjes dhe kryetarja e CDU-së në pushtet në Gjermani, Annegret Kramp-Karrenbauer.

Të dielën ajo tha në Kosovë se ka sfida të reja që i vijnë këtij rajoni. "Ne ndiejmë një ndikim në rritje të Rusisë dhe Kinës", u shpreh Kramp-Karrenbauer. Komisionari i ri për zgjerimin e BE-së, hungarezi Oliver Varhelyi ka deklaruar se në fillim të janarit 2020 Komisioni Evropian do të paraqesë një propozim konkret, për të ndryshuar metodologjinë e

zgjerimit të BE-së.

Por sipas burimeve të DW, Varhelyi shtoi se perspektiva evropiane e Ballkanit Perëndimor nuk është në pikëpyetje, ajo "nuk do të diskutohet". Për ta konfirmuar këtë ai tha se do të hapet një kapitull i ri i negociatave të BE-së me Serbinë.

Këto janë deklarata të rëndësishme të politikanëve gjermanë dhe evropianë që kërkojnë që reformimi i BE-së të bëhet paralelisht me zhvillimin e negociatave. Por gjasat që Franca t'i përmbahet në vazhdimësi bllokimit të nisjes së negociatave me kandidatët nga Ballkani janë padyshim reale.



Shqipëria merr Presidencën e OSBE-së

Kryeministri Edi Rama theksoi se marrja e presidencës është një moment historik dhe inspirim për vendin tonë dhe kjo lidhet me marrëdhëniet e mira me anëtarët dhe mikpritje si dhe harmonia fetare që karakterizon Shqipërinë

TI Ranë, 6 DHJETOR - Shqipëria të premten zyrtarisht ka marrë kryesimin e Presidencës së OSBE-së për vitin 2020. Në Bratislavë, së bashku me kryeministrin Edi Rama, ishte edhe ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj.

Kryeministri Rama u shpreh se është përgjegjësi e madhe drejtimi i kësaj organizate ndërkombëtare të dorës së parë, por edhe mundësi e jashtëzakonshme për ta bërë Shqipërinë të shkëlqejë në krye të punëve të mëdha e të sfidave të posaçme të OSBE-së. "Ky është një moment historik dhe inspirim për Shqipërinë. Ne kemi marrë vendim sa i përket të ardhmes së vendit tonë se si e shohim të ardhmen në vitet e ardhshme. Shpresoj tek iniciativa jonë me partnerët për ta vijuar

bashkëpunimin. Ka shumë vendime kyçe me të cilat ne nuk kemi marrëveshje të qëndrueshme. Ka, në fakt, shumë çështje që kanë të bëjnë jo vetëm me termat e politikës, por edhe të sigurisë. Shohim se edhe në këtë tryezë ka qasje të ndryshme. Do të bëjmë të pamundurën për të bërë përpara. Ky është një moment historik dhe inspirim për vendin tonë. Kjo lidhet me marrëdhëniet e mira me anëtarët dhe mikpritje që karakterizon Shqipërinë. Edhe një tjetër element i rëndësishëm i Shqipërisë është harmonia fetare. Marrja e Presidencës është një hap i jashtëzakonshëm", ka thënë Rama.

Ai ka shtuar se do të fokusohen në bashkëpunimin e të gjitha politikave për ta rritur kredi-



bilitetin në kuadër të kësaj organizate. "Nëse doni paqe në Evropë duhet të implementohen edhe elemente të tjera. Duke monitoruar zgjedhjet dhe mbështetur reformat, puna e OSBE-së ka qenë ngushtësisht e lidhur me njerëzit. Sa i përket edhe vijimit të dialogut, kjo është e vetmja mënyrë për ta rindërtuar besimin mes nesh. Korrupsioni dëmton prosperitetin e të gjithë rajonit, së

bashku me kërcënimet e tjera. Do ta luftojmë korrupsionin. Nder dhe përgjegjësi e madhe drejtimi i kësaj organizate ndërkombëtare të dorës së parë si dhe mundësi e jashtëzakonshme për ta bërë Shqipërinë të shkëlqejë në krye të punëve të mëdha e të sfidave të posaçme të OSBE-së", ka thënë Rama.

"Në mbledhjen tonë këtu, në Bratislavë, arritëm konsensus mbi shumë vendime të rëndë-

sishme, gjë që më jep besimin, se pavarësisht ndasive tona, arritjet janë të mundshme, nëse jemi të duruar, këmbëngulës dhe të gatshëm të krijojmë hapësirën e nevojshme diplomatike. Në veçanti përshëndesim vendimin e presidencave të ardhshme suedeze dhe polake, që përmirësojnë aftësinë tonë për t'i dhënë drejtum strategjik OSBE-së në vitet e ardhshme", tha Rama.

Ambasada e ShBA-së përkrah rimëkëmbjen e Shqipërisë pas tërmetit



TI Ranë, 6 DHJETOR - Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Tiranë po ndjek me vëmendje zhvillimet në terren pas tërmetit të 26 nëntorit, si pasojë e të cilit 51 persona humbën jetën dhe qindra të tjerë mbetën të plagosur dhe të pastrehë.

Përmes një postimi në 'Facebook', ambasada thotë se

inxhinierët po punojnë për t'i përcaktuar ndërtesat si të sigurta apo të pasigurta, për të ndihmuar njerëzit që të kthehen të sigurt në shtëpi.

"Si pjesë e mbështetjes së vazhdueshme të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara në përpjekjet për rimëkëmbjen pas tërmetit të 26 nëntorit, ekipi i inxhinierëve të strukturave nga Zyra për ndih-

më të jashtme në raste fatkeqësish e USAID-i, po vijon të kryejë vlerësime në terren së bashku me inxhinierët shqiptarë dhe ndërkombëtarë. Inxhinierët po punojnë për t'i përcaktuar ndërtesat si të sigurta apo të pasigurta, për të ndihmuar njerëzit që të kthehen të sigurt në shtëpi", thuhet në njoftimin e Ambasadës së ShBA-së.

SBASHK-u, FSSHK-ja dhe PSK-ja kanë kërkuar takim me përfaqësuesit e shtetit pas dërgimit të Ligjit për paga në Gjykatën Kushtetuese

Dërgimi i Ligjit për paga në Kushtetuese sjell pakënaqësi te punëtorët e sektorit publik

Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK), Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) dhe Sindikata e Policisë së Kosovës (PSK) kanë kërkuar të premtën takim urgjent me përfaqësuesit kryesorë të shtetit pas dërgimit të Ligjit për paga në Gjykatën Kushtetuese nga Avokati i Popullit. "Ky takim kërkohet me qëllim të informimit nga ana e tri sindikatave për pasojat e mundshme në rast të mosimplementimit të Ligjit për paga. Takimi duhet të mbahet më së largu deri të martën", është thënë në deklaratën e përbashkët të këtyre tri sindikatave



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Pesë ditë pas hyrjes në fuqi të Ligjit për paga për sektorin publik, institucioni i Avokatit të Popullit e ka dërguar atë në Gjykatën Kushtetuese për, siç thuhet, vlerësimin e përputhshmërisë së këtij ligji me Kushtetutën. Avokati i Popullit ka kërkuar vendosjen e masës së përkohshme ndaj zbatimit të Ligjit për paga në sektorin publik deri në një vendim përfundimtar nga Gjykata Kushtetuese.

Avokati i Popullit ka bërë me dije se ka pranuar 35 ankesa nga subjektet e ndryshme të sektorit publik të parashtruara kundër Ligjit për paga në sektorin publik, duke përfshirë këtu ankesat nga të punësuarit në shëndetësi, në arsim, në polici dhe në shërbimin civil.

Ligji për paga, i sapohyrë në fuqi, rregullon rritjen e pagave për 70 për qind të punëtorëve në sektorin publik, kurse 30 për qind mbeten jashtë.

Ligji për paga do të duhej të zbatohet nga janari i vitit 2020, ku përfshihen pagat e muajit dhjetor 2019. Por, për shkak të kontestimit të këtij

ligji në Gjykatën Kushtetuese, mbetet e paqartë nëse punonjësit e përfshirë në rritje të pagave me këtë ligj do t'i marrin rrogat me rritje nga janari.

Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka afat ligjor prej 60 ditësh për t'i dhënë një përgjigje kërkesës së Avokatit të Popullit.

Kryetarët e tri sindikatave në Kosovë, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, e Shkencës dhe e Kulturës (SBASHK), Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës (FSSHK) dhe Sindikata e Policisë së Kosovës kanë kërkuar që mos të zvarritet zbatimi i ligjit. Këto tri sindikata të premtën kanë mbajtur një takim të përbashkët dhe kanë kërkuar takim urgjent më së largu deri të martën me presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, kryeministrin në detyrë, Ramush Haradinaj, dhe me kryetarët e subjekteve politike parlamentare. "Ky takim kërkohet me qëllim të informimit nga ana e tri sindikatave për pasojat e mundshme në rast të mosimplementimit të Ligjit për paga. Takimi duhet të mbahet më së largu deri të martën", është thënë në deklaratën e përbashkët të këtyre

tri sindikatave të nënshkruar nga kryetari i i SBASHK-ut, Rahman Jasharaj, Blerim Sylja nga FSSHK-ja dhe Shaban Tasholli nga Sindikata e Policisë së Kosovës (SPK).

Kryetari i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, të Shkencës dhe të Kulturës së Kosovës (SBASHK), Rahman Jasharaj, ka thënë se nëse nuk do të zbatohet Ligji për paga nga ky muaj mund të ketë reagime dhe veprime nga kjo sindikatë. Jasharaj ka bërë me dije se për këtë çështje e kanë njoftuar edhe Avokatin e Popullit. "Në takim me Avokatin e Popullit isha bashkë me kryetarin e Sindikatës së Shëndetësisë, Blerim Sylja dhe me kryetaren e Sindikatës së Policisë, Valbona Kamberi. E kemi informuar Avokatin e Popullit lidhur me situatën që është krijuar mes anëtarësisë së këtyre tri sindikatave pasi është thënë dhe është dëgjuar se ai, mbase, do ta dërgojë Ligjin e Pagave në Kushtetuese. SBASHK-u fillimisht kishte bërë angazhime të shumta që Projektligji për paga të tërhiqej dhe të uleshin të gjitha palët e ta përgatitnin si duhet sepse, e kemi thënë shumë herë dhe publikisht, se Projektligji ishte i dobët dhe, për sistemin arsimor, degradoes

dhe nënçmues. Por, kjo nuk u bë dhe u desh të bëjmë shumë angazhime të tjera, pastaj edhe grevë, për t'i ndryshuar koeficientet. Njerëzit kanë qenë në pritje që Ligji për paga të nisë të zbatohet me pagën e dhjetorit dhe ia kemi thënë Avokatit të Popullit se, nëse kjo nuk ndodh, mund të ketë reagime dhe veprime", ka thënë Jasharaj. Në këtë kontekst, Jasharaj ka thënë se do ta respektojë zërin e punëtorëve të arsimit. "Unë, si gjithmonë, do ta respektoj zërin e punëtorëve të tërë sektorit të arsimit. Do të veproj ashtu si kërkohet ata dhe ashtu si vendos Këshilli Drejtues i SBASHK-ut, në të cilin janë përfaqësuesit e tërë sektorit të arsimit, nga çerdhet, arsimit parauniversitar dhe universitetet", është shprehur Jasharaj. Edhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës në mbledhjen e jashtëzakonshme të kryesisë së saj të mbajtur më 6 dhjetor ka marrë vendim që më 11 dhjetor të mbahet mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit Drejtues të FSSHK-së, në të cilin do të merren vendimet e mëtejshme në lidhje me veprimet sindikale. "Kjo bëhet pas marrëveshjes me SBASHK-un dhe SPK-në, ku është vendosur që

deri të martën t'i jepet hapësirë dialogut social. Deri në mbledhjen e Këshillit Drejtues lutet anëtarësia e gjerë e FSSHK-së që të mos bie pre e manipulimeve të cilat vijnë nga qarqet e ndryshme politike dhe parapolitike. Për çdo lëvizje apo veprim sindikal do të njoftoheni me kohë", është thënë në njoftimin e FSSHK-së.

Edhe Oda e Mjekëve të Kosovës ka theksuar se pezullimi i mundshëm i të zbatuarit të Ligjit për pagat i cili tanimë është dërguar për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese, nga Oda e Mjekëve të Kosovës vlerësohet si veprim i papranueshëm. Oda e Mjekëve të Kosovës ka vlerësuar se demin më të madh do ta pësojë punëtori shëndetësor, i cili tashmë është degraduar profesionalisht dhe ekonomikisht. "Kjo do të ishte edhe një shtyrje më tepër drejt trendit të ikjes së mjekëve", është thënë njoftimin e Odës së Mjekëve të Kosovës. Numri i punonjësve që marrin paga nga buxheti i Kosovës është rreth 82 mijë veta. Paga mesatare në sektorin publik, sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në vitin 2018 ishte 573 euro.

Haradinaj vizitoi të strehuarit nga Shqipëria në Parkun Inovativ në Prizren

PRIZREN, 6 DHJETOR (ER) - Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës, Ramush Haradinaj, ka vizituar të premtën banorët e Shqipërisë, të strehuar përkohësisht në Parkun Inovativ Trajnues Kosovaro-Gjerman në Prizren. Gjatë kësaj vizite kryeministri në detyrë, Haradinaj, zhvilloi një takim me ambasadorin e Gjermanisë në Kosovë, Christian Heldt, kryetarin e Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, menaxhmentin e Parkut Inovativ, drejtuesit e policisë së rajonit të Prizrenit, drejtuesin e shoqatës "Nënë Tereza", Zef Shala, përfaqësuesit e Shoqatës së Gastronomëve të



Prishtinës dhe vullnetarët e angazhuar në Parkun Inovativ Trajnues Kosovaro-Gjerman në Prizren.

Kryeministri në detyrë,

Haradinaj, është njoftuar me të gjitha ecuritë në Parkun Inovativ Trajnues, për angazhimet institucionale dhe të donatorëve e të vullnetarëve dhe për gjendjen

shëndetësore të të strehuarve. Me këtë rast, Haradinaj tha se Kosova është angazhuar me të gjitha mekanizmat për t'u dalë në ndihmë banorëve të Shqipërisë dhe se tani po punohet, në koordinim me autoritetet shqiptare, për rikthimin e tyre në Shqipëri.

Parku Inovativ Trajnues Kosovaro-Gjerman, që pas tërmetit me pasojat tragjike që goditi Shqipërinë, u bë strehë e qindra bashkëkombësve tanë. Fillimisht në park ishin akomoduar dhe strehuar mbi 500 persona. Pas regjistrimit dhe evidentimit të këtyre personave, tashmë kanë nisur edhe procedurat e kthimit në baza vull-

netare.

Aktualisht në park po qëndrojnë rreth 300 persona, derisa kthimi i tyre i organizuar dhe menaxhuar në mënyrë institucionale po vazhdon çdo ditë.

Kryeministri në detyrë, Haradinaj, theksoi se Kosova, pas veprimeve të para që ka ndër-marrë për ta ndihmuar Shqipërinë dhe pas strehimit të përkohshëm të banorëve të saj në Kosovë, do ta vazhdojë angazhimin e nevojshëm për rikthimin e tyre dhe, gjithashtu, pas procesit të rikthimit, do të jetë në gjendje gatishmërie për t'u dalë në ndihmë, në rast nevojë, institucioneve të Shqipërisë për tejkalimin e kësaj situatë.



Analistët politikë tregojnë se si Lëvizja Vetëvendosje dhe Lidhja Demokratike e Kosovës mund ta tejkalojnë çështjen e postit të presidentit të ardhshëm

Analistët: Zgjedhja e presidentit nga qytetarët tejkalon ngërçet politike

Njohësit e rrethanave politike dhe kushtetuese në vend kanë bërë me dije se Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) duhet të bëjnë një kompromis për çështjen e presidentit në mënyrë që sa më shpejt të vijë deri te një marrëveshje për bashkëqeverisje. Mazllum Baraliu dhe Ismet Kryeziu kanë vlerësuar se LV-ja dhe LDK-ja duhet të pajtohen që zgjedhja e presidentit të bëhet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët ose të gjejnë një kandidat konsensual për këtë post

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Përderisa posti i presidentit të ardhshëm ka dalë si pengesë në negociatat e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për arritjen e koalicionit qeverisës, njohësit e rrethanave politike dhe kushtetuese në vend i kanë ftuar këto dy subjekte politike që ta bëjnë një kompromis rreth kësaj çështje. Ata kanë deklaruar se zgjedhja mund të jetë zgjedhja e presidentit

drejtpërdrejt nga qytetarët ose gjetja e një kandidati konsensual për këtë çështje.

Ismet Kryeziu, drejtor ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) duhet të arrijnë kompromis që presidenti të zgjedhet nga qytetarët. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se zgjedhja e presidentit gjithëherë u është nënshtruar përplasjeve dhe ngërçeve politike. "Kompromisi që duhet ta

arrijnë LV-LDK është zgjedhja e presidentit në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët. Zgjedhja e presidentit gjithëherë u është nënshtruar përplasjeve dhe ngërçeve politike. Madje pika më e lartë e mosmarrëveshjeve është shënuar në vitin 2011, kur është nevojitur edhe ndërmjetësimi i partnerëve ndërkombëtarë për të ardhur deri te një kompromis, pas të cilit erdhi deri te zgjedhja e znj. Atifete Jahjaga për presidente të vendit, e cila nuk kishte as portofol dhe as bagazh politik. Aq më tepër

ishite e panjohur për pjesën më të madhe të qytetarëve", ka shkruar Kryeziu. Ai ka shtuar se jo vetëm zgjedhja, por edhe kundërkandidimi si kriter kushtetues është parë si problematik dhe devalvim i kësaj pozite dhe veprimeve politike për ta përmbushur këtë obligim kushtetues. "Ju kujtohet zgjedhja e presidentit Thaçi dhe kundërkandidatit të tij, Rafet Rama", ka shkruar ai. Kryeziu ka theksuar se LV-ja dhe LDK-ja pas arritjes së konsensusit për numrin e dikastereve të qeverisë dhe pas harmonizimit të çështjeve programore, patjetër duhet ta kenë si prioritet pajtimin për iniciimin e reformës zgjedhore. "Tani në fazën finale të marrëveshjes, kur këto dy subjekte kanë nevojë për kompromise për ndarjen e përgjegjësiqe qeverisëse, portofoleve të veçanta për secilën ministri, për emra të ministrave etj., përmes

marrëveshjes për reformë zgjedhore do t'i shmangnin përplasjet dhe ngërçin rreth pozitës së presidentit. Kompromisi për zgjedhje të drejtpërdrejtë të presidentit me votën e qytetarëve do të duhej të ishte prioritet jo vetëm për koalicionin e tyre. Kështu do të prodhohej një zgjidhje edhe për të ardhmen, për secilën parti e koalicion që do ta merrte mandatin për të qeverisur. Do të ishte zgjidhje afatgjatë e shmangies së pazareve politike, konfrontimeve, provokimit të zgjedhjeve të parakohshme, do ta ndalonte degradimin e kësaj pozite e cila është pozita e parë shtetërore dhe do të duhej të kishte vlera të unifikimit qytetar e politik", ka thënë Kryeziu. Kurse njohësi i çështjeve kushtetuese në vend, Mazllum Baraliu, ka përmendur edhe përparësitë e tjera të zgjedhjes së presidentit nga qytetarët. Ai ka

cional dhe demokratik, për unitetin demokratik të popullit dhe për mbarëvajtjen e të gjitha linjave institucionale të shtetit", ka thënë Baraliu.

Ai ka treguar se LV-ja dhe LDK-ja këtë pengesë në negociatat e tyre mund ta kalojnë me parimësi dhe mirëkuptim. "Me Kushtetutë partisë fituese i takojnë kryeministri dhe kryetari i Kuvendit, por LV-ja i ka ofruar LDK-së postin e kryeparlamentarit dhe zëvendëskryeministrin e parë. Tani mendoj se çështja e presidentit është e parakohshme, sepse ka të bëjë me një marrëveshje paragjyqese, me një pozicion që nuk është vakant, për faktin se nuk dihet se në çfarë konstelacioni dhe atmosfere mund të jetë situata në momentin e përfundimit të mandatit të presidentit të tanishëm", është shprehur Baraliu. Më tej, ai ka vlerësuar se këto dy parti mund të vendosin një standard tjetër në këtë çështje, duke zgjedhur një kandidat konsensual për president. "Mendoj se do të duhej që me korrektësi LDK-ja të heqë dorë nga presidenti, apo të vijë në shprehje varianti i dytë që, për mendimin tim, ka të bëjë me një solucion që parimisht të hyjë në pako edhe marrëveshja për presidentin, por që president të mos jetë i LDK-së dhe as i LV-së. Pra, të jetë kandidat konsensual, jashtë politikës. Ky do të ishte edhe një standard i ri i vendosur nga këto dy subjekte politike për të dalluar nga praktika e deritashme ku zgjedhja e presidentit ka qenë e vështirë", ka thënë Baraliu.

LV-ja dhe LDK-ja ende nuk kanë arritur një marrëveshje për bashkëqeverisje, ndonëse një gjë të tillë e kishin paralajmëruar se do të ndodhë menjëherë pas certifikimit të rezultatit zgjedhor nga KQZ-ja. Zyrtarët e të dy subjekteve politike kanë pranuar se peng për arritjen e marrëveshjes është paraqitur posti i presidentit të ardhshëm dhe drejtimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Thaçi: BE-ja, standarde të dyfishta; shtetet bashkëpunuese po i bllokun, shtetet shantazhuese po i shpërblen

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, në konferencën e organizuar në Berlin nga Instituti "Lindje-Perëndim", ka folur për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe procesin e liberalizimit të vizave. Para shumë përfaqësuesve shtetërorë të ShBA-së, BE-së dhe shoqërisë civile, Thaçi ka thënë se po shohim se BE-ja ka standarde të dyfishta. "Derisa Kosova bllokohet në liberalizim dhe Maqedonia dhe Shqipëria bllokohen në hapjen e negociatave, Serbisë i premtohet hapje e kapitujve të rinj. Shohim që ata që shpërblehen janë ata që shantazhojnë BE-në me raportin me Rusinë", ka thënë Thaçi



**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

BERLIN, 6 DHJETOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, në konferencën e organizuar në Berlin nga Instituti "Lindje-Perëndim", si panelist kryesor ka folur për procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

Presidenti Thaçi ka thënë se pikërisht kur po mbahej samiti i NATO-s në Londër, presidenti i Serbisë udhëtoi për në Rusi dhe ky është mesazh i orientimit të tyre. "Ky është mesazh për orientimin e Serbisë. Po ashtu, gjatë ditës së djeshme kemi dëgjuar deklarata nga liderët serbë, duke i mohuar krimet dhe gjenocidin në Kosovë", ka thënë presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka thënë në Berlin se marrëdhëniet e Kosovës me Serbinë nuk ndikojnë vetëm në rrafshin bilateral, por edhe në stabilitetin e rajonit dhe të BE-së.

Duke folur për perspektivën euroatlantike të shteteve të Ballkanit Perëndimor, presidenti Thaçi ka theksuar se Kosova duhet ta marrë liberalizimin e vizave sa më shpejt të jetë e mundur. "Këtë nuk e shohim si dhuratë, por është diçka që Kosova e meriton dhe ka plotësuar kriteret për ta marrë. Së

dyti, hapja e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë duhet të bëhet në të ardhmen e afërt. Bllokimi i negociatave ishte mesazh i keq për të gjithë Ballkanin Perëndimor", ka thënë presidenti Thaçi.

Para shumë përfaqësuesve shtetërorë të ShBA-së, BE-së dhe shoqërisë civile, presidenti Thaçi ka thënë se po shohim se BE-ja ka standarde të dyfishta. "Derisa Kosova bllokohet në liberalizim dhe Maqedonia me Shqipërinë bllokohen në hapjen e negociatave, Serbisë i premtohet hapje e kapitujve të rinj. Shohim që ata që shpërblehen janë ata që shantazhojnë BE-në me raportin me Rusinë", ka thënë ai.

Sipas presidentit Thaçi, kur kanë nisur bisedimet në vitin 2012 një nga rregullat e pashkruara ka qenë që s'do ta kushtëzojmë procesin, kurse tash taksa po përdoret për ta kushtëzuar dialogun. "Si të lëvizim përpara? Nga përvoja në procese deri më tash dua t'i përmend dy gjëra. E para, uniteti i shteteve të Kuintit, i cili është kyç që të vazhdojmë përpara me procesin. Dhe, e dyta, koordinim i plotë ShBA dhe BE, edhe pse as ky koordinim nuk bën shumë punë kur vende të Bashkimit Evropian nuk lodhen

se çka vendos BE-ja. Disa prej tyre madje shkaktojnë edhe shumë konfuzion në shtetet tona, te politikanët dhe te qytetarët", ka theksuar presidenti Thaçi. Ai ka shtuar se këto janë kushtet për ta rinisur procesin dhe për arritjen e marrëveshjes finale, kurse dialogu dhe marrëveshja përfundimtare, sipas tij, nuk kanë alternativë për stabilitetin e Ballkanit.

Presidenti Thaçi ka folur edhe për procesin zgjedhor në Kosovë dhe përpjekjet për krijimin e një qeverie të re. Ai ka thënë se Kosova ka kaluar suksesshëm një test të demokracisë, pa marrë parasysh rezultatit zgjedhor. "Partia fituese duhet ta fillojë formimin e qeverisë. Dua të theksoj se çdo proces me Serbinë do të trajtohet në nivel të dy shteteve sovraane dhe me konsensus politik në Kosovë. Unë jam president dhe do të investoj për arritjen e konsensusit të brendshëm në Kosovë. Polarizimet nuk ndalen në sistem pluralist, por ka ardhur koha të kemi një pako të prioritetëve në mes të pozitës dhe opozitës, që në këto çështje të mos ketë dallime", ka thënë ai. Kreu i shtetit është zotuar se si president i vendit do ta luajë rolin e tij për bashkimin e skenës politike.

thënë për gazetën "Epoka e re" se reforma kushtetuese për ndryshimin e mënyrës së zgjedhjes së presidentit është e gatshme. "Zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit ka shumë përparësi dhe ka shumë anë pozitive më tepër se kjo që është tani. Zgjidhja e drejtpërdrejtë e presidentit në radhë të parë legjitimon dukshëm më tepër presidentin në pozitën e tij për ta zbatuar dispozitën e nenit 84 të Kushtetueses, ku ka mbi 30 kompetenca. Kjo do të bënte që presioni të jetë më kredibil në raport me institucionet e vendit për të cilat presidenti me Kushtetutë është i detyruar të kujdeset për zhvillimin institu-



Avokati Gashi bën kallëzim penal kundër Aleksandër Vuçiqit



PRISHTINË, 6 DHJETOR - Avokati Tomë Gashi ka bërë me dije të premtën se ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës kundër presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për shkak të mohimit të masakrës së Reçakut. "Kallëzim penal kundër presidentit të Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për veprën penale të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar apo etnik nga neni 147 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës", ka shkruar Gashi në llogarinë e vet në "Facebook".

Të enjten presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, deklaroi se sa i përket Reçakut në vitin 1999 "bëhet fjalë për krim të trilluar dhe se gjithçka ishte trillim i një mashtruesi, siç është William

Walker". "Këtë do ta përsëris çdo ditë dhe të shohim se kush do të na gjykojë", ka deklaruar Vuçiq. Ndaj deklarates së Vuçiqit kanë reaguar përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, presidenti Hashim Thaçi dhe kryeministri Ramush Haradinaj. Thaçi ka thënë se "paqja, pajtimi, drejtësia nuk mund të ndërtohen bazuar në mohimin e krimeve". "Disa zyrtarë nga Serbia mohojnë disa nga krimet më të rënda kundër civilëve që ndodhën në Evropë, sikurse ishte Reçaku, të konfirmuara edhe nga Gjykata e Hagës për krimet e luftës në ish-Jugosllavi. Politikat serbe të gjenocidit nuk mund të mbrohen. Ata duhet të denoncohen. Paqja, pajtimi, drejtësia nuk mund të ndërtohen bazuar në mohimin e krimeve", ka thënë Thaçi.

Mungesa e vaksinave rëndoi gjendjen me gripin sezonal në Kosovë

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Rreth 10 000 persona janë diagnostikuar si të prekur nga gripin sezonal në Kosovë në javët e fundit. Por, ky numër nuk e kalon pragun epidemik thonë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës. Bëhet me dije se dy persona me grip janë të shtrirë në Klinikën Infektive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës në gjendje të rëndë shëndetësore. Numri më i madh i rasteve raportohet të jenë nga Komuna e Prishtinës, pastaj nga ajo e Prizrenit dhe Podujevës.

Në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë së Kosovës thonë se në periudhën e gripave duhet të vaksinohen të gjithë personat e moshuar mbi 65 vjeç si dhe personat me sëmundje kronike. Vaksinimi bëhet në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare. Por, problemi sivjet ishte se vaksinat kundër gripit sezonal kanë munguar, ndërkohë që afati më i përshtatshëm për marrjen e tyre

thuhet se është fundi i muajit tetor.

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Prishtinë, doktori Nexhmedin Hoti i tha "Radios Evropa e Lirë" se vaksinat pritet të jenë në dispozicion për qytetarët javën e ardhshme. "Ministria e Shëndetësisë ka deklaruar se vaksinat nga java tjetër do të shpërndahen nëpër të gjitha qendrat e mjekësisë familjare në Kosovë. Po të kishte mundësi t'i merrnin më herët vaksinat, do të ishte më mirë. Por, edhe tash kur furnizohemi është mirë të vijmë njerëz dhe të vaksinohen", ka thënë Hoti.

Ndërsa infektologu Sali Ahmeti ka thënë se dy personat e shtrirë në Klinikën Infektive janë të konfirmuar me influencë A të gripit dhe janë në gjendje të rëndë, por po mbahen nën monitorim dhe përkujdesje të vazhdueshme. "Sigurisht se raste të gripit ka shumë, por këto dy raste janë në



gjendje të rëndë. Sa iu përket vaksinave, do të ishte mirë që qytetarët të vaksinoheshin shumë më herët. Vonesa e tyre sigurisht se ka rritur numrin e të prekurve me grip, por edhe shfaqje të formave më të rënda dhe komplikime të qytetarët", ka sqaruar Ahmeti.

Ndërkaq nga Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik, zëdhënësjë Era Pireva ka deklaruar se Instituti

Kombëtar bën thirrje të të gjithë drejtorët rajonalë të Shëndetësisë Publike që të ngrihet niveli i vigjilencës dhe raportimit të rasteve të dyshimta në të gjitha institucionet shëndetësore publike dhe private në Kosovë. "Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të influencës sezonale me shtim të aktiviteteve gjatë sezonit përkatës tetor-maj.

Për këtë periudhë kohore janë raportuar gjithsej 9 545 raste të dyshimta me grip. Megjithatë, nuk është shpallur ndonjë epidemi dhe situata është nën kontroll", ka thënë Pireva.

Gjatë këtij viti, përkatësisht në muajin shkurt, Instituti Kombëtar të Shëndetit Publik pati shpallur gjendje epidemike të gripit. Ndërkaq, nga muaji tetor i vitit 2018 deri në shkurt të vitit 2019 nga gripin patën vdekur 11 persona.

Viruset sezonale, sipas mjekëve, bëhen më agresive për shëndetin e njeriut kur ambienti është i papastër. Kosova, aktualisht, është radhitur nga mekanizmat ndërkombëtarë në nivelin më të ulët të standardeve mjedisore në Ballkanin Perëndimor dhe në Evropë dhe ka cilësi të ajrit të pashëndetshme, e në disa ditë gjatë vjeshtës dhe dimrit cilësia e ajrit bëhet e rrezikshme për shëndetin e njeriut.

Aktakuzë kundër dy shtetasve të Shqipërisë për kontrabandim të migrantëve

PRIZREN, 6 DHJETOR (ER) - Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër L. B. dhe A. R., të dy shtetas nga Republika e Shqipërisë, të cilët gjenden në paraburgim nga data 10. 11. 2019 për shkak të dyshimit të bazuar se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale "Kontrabandimi i migrantëve", nga neni 164, paragrafi 1 dhe paragrafi 8, pika 1 dhe 2 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK). Sipas aktakuzës, më 10. 11. 2019

rreth orës 02:15 në Prizren është vërtetuar se të pandehurit L. B. dhe A. R. në bashkëkryerje merren me kontrabandim të migrantëve me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejtë të dobisë pasurore, në atë mënyrë që derisa zyrtarët e policisë kufitare të pikë kalimit kufitar në Vermicë ishin në kryerjen e detyrës zyrtare, përmes vëzhgimit me dylbi në vendin e quajtur "Foleja e Shqiponjës" në afërsi të krojeve të fshatit Vermicë, kanë vërejtur një grup njerëzish duke kaluar ilegalisht kufirin nga Republika e Shqipërisë për në Republikën e

Kosovës. Të pandehurit së bashku me grupin e personave të tjerë janë ndalur nga ana e Policisë Kufitare si dhe, pas verifikimit nga zyrtarët policorë, është vërtetuar se të njëjtit ishin shtetas të huaj nga Republika e Sirisë, të cilët, më pas, së bashku me dy të pandehurit e lartpërmendur, janë shoqëruar në Stacionin Policor në Vermicë. Me këto veprime ekziston dyshimi i bazuar se të pandehurit L. B. dhe A. R. kanë përmbyshur elementet e veprës penale "Kontrabandimi i migrantëve" sipas KPRK-së. Prokurori i çësht-



jes, me rastin e ngritjes së aktakuzës, i ka propozuar Gjykatës që të pandehurit të

shpallen fajtorë dhe të dënohen sipas ligjit për veprën penale e cila u vihet në barrë.

KDI-ja: Vazhdimi i dialogut nuk duhet ta gjejë Kosovën pa konsensus të brendshëm



Sa iu përket efekteve që mund të sjellë arritja ose jo e konsensusit politik, Krasniqi ka deklaruar që në planin e brendshëm arritja e konsensusit do t'i evitonte situatat e kundërshtimit të një marrëveshje eventuale, ndërsa në planin e jashtëm do ta forconte në rend të parë pozitën negociuese të Kosovës në raport me Serbinë, por edhe do t'i lehtësonte iniciativat për lobim në vendet e treta. "Kurse vazhdimi i mungesës së konsensusit do të ndikojë në paralizimin e jetës institucionale, pamundësinë e ratifikimit në Kuvend të një marrëveshje eventuale si dhe mungesën e qëndrimit unik të palës së Kosovës kundrejt Serbisë dhe partnerëve ndërkombëtarë", është shprehur ajo.

Duke u bazuar në të gjeturat e kësaj analize, si dhe marrë parasysh rëndësinë që ka konsensusi i brendshëm politik në raport me procesin e dialogut, si procesi më i ndjeshëm politik në të cilin po kalon Kosova, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka ofruar rekomandimet rreth këtij procesi: 1. Qeveria e re duhet t'i shtojë përpjekjet për arritjen e konsensusit në mes të spektrit politik lidhur me të gjitha fazat e dialogut për arritjen e marrëveshjes përfundimtare me Serbinë, duke përfshirë atë parapërgatitore, përgatitore, përcaktimin e agjendës dhe opsionet mbi marrëveshjen përfundimtare me Serbinë. Konsultimet duhet të zhvillohen mbi bazën e mirëbesimit, duke vendosur në plan të parë interesin e shtetit të Kosovës; 2. Subjektet opozitare duhet të jenë po aq të përgjegjshme për arritjen e konsensusit për çështje të interesit shtetëror. Ato duhet të tregojnë përkushtim dhe konstruktivitet në mënyrë që të tejkalohen pengesat për arritjen e pajtueshmërisë; dhe 3. Presidenti dhe kryeministri i vendit, në përputhje të përgjegjësisë të tyre kushtetuese, duhet të konsultohen në mënyrë të vazhdueshme dhe t'i kontribuojnë ndërtimit të konsensusit politik lidhur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi.

"Duke konsideruar rëndësinë dhe ndjeshmërinë që ka për Kosovën dhe qytetarët e saj përmbyllja e procesit të dialogut me Serbinë është e nevojshme që të arrihet një pajtueshmëri në mes të spektrit politik lidhur me vazhdimin e dialogut, përkatësisht parimet mbi të cilat pala e Kosovës do ta përmbyllë këtë proces", ka thënë Violeta Haxholli nga KDI-ja me rastin e publikimit të analizës "Konsensusi i brendshëm si parakusht për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi"

EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka publikuar të premten analizën "Konsensusi i brendshëm si parakusht për vazhdimin e dialogut Kosovë - Serbi" lidhur me rëndësinë e arritjes së konsensusit politik për procesin e dialogut me Serbinë si një nga proceset më të rëndësishme në të cilat po kalon vendi.

Gjatë konferencës për media, Violeta Haxholli nga KDI-ja ka thënë se kjo analizë tenton t'i japë publikut një pasqyrë më të gjerë të efekteve që ka prodhuar mungesa e deritanishme e kon-

sensusit në mes të spektrit politik lidhur me dialogun si dhe efektet që mund të ketë në këtë proces vazhdimi i mungesës së konsensusit politik.

Haxholli, duke folur lidhur me qëndrimet e spektrit politik rreth fazës përmbyllëse të dialogut, ka theksuar se arritja e pajtimit të gjerë politik pritet të jetë e vështirë. "Përplasjet politike të cilat mund të vazhdojnë në mes të udhëheqësve institucionale do të ndikojnë negativisht për arritjen e konsensusit mes spektrit politik, ndërsa vazhdimi të polarizimeve në qëndrime mund t'i kontribuojnë edhe inatet e vjetra politike dhe kalkulimet partiake", është shprehur ajo.

Haxholli ka thënë se mospajtimet e spektrit politik lidhur me aspektet të caktuara të këtij procesi kanë çuar vendin në kriza të shpeshta politike dhe institucionale. "Duke konsideruar rëndësinë dhe ndjeshmërinë që ka për Kosovën dhe qytetarët e saj përmbyllja e procesit të dialogut me Serbinë, është e nevojshme që të arrihet një pajtueshmëri mes spektrit politik lidhur me vazhdimin e dialogut, përkatësisht parimet mbi të cilat pala kosovare do ta përmbyllë këtë proces", ka thënë ajo.

Në anën tjetër, Jeta Krasniqi nga KDI-ja shpalosi çështjet lidhur me të cilat duhet domosdo të arrihet konsensusi politik. Ajo ka

potencuar se formati i dialogut, dimensionin kohor për arritjen e marrëveshjes eventuale me Serbinë dhe temat që duhet të jenë pjesë e dialogut janë elementet rreth të cilave është tejet e rëndësishme arritja e konsensusit të brendshëm politik. Sipas Krasniqit, çështje tjetër mjaft e rëndësishme janë edhe marrëveshjet e arritura deri më tani, statusi juridik i pjesës më të madhe të të cilave vazhdon të mbetet i padefinuar qartazi. "Përveç këtyre elementeve, edhe lobimi mbi bazën e një qëndrimi unik duhet ta shoqërojë këtë proces që nga hapat e parë, ndryshe nga praktikata e gabuara të së kaluarës", ka thënë ajo.

Përurohen ambulancat e reja specialistike në Spitalin e Gjilanit

GJILAN, 6 DHJETOR (ER) - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Uran Ismaili dhe drejtori i Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, Basri Sejdiu, përurojnë të premten në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit ambulancat e reja specialistike.

Ministri Ismaili ka thënë se me investimet e bëra në këto ambulanca është krijuar një ambient pune mjaft mbresëlënës. "Kur kemi ardhur në fillim ka qenë mjaft i zymtë ambienti i punës dhe me këtë investim janë krijuar

kushtet për pacientët dhe personelin shëndetësor si dhe është bërë digjitalizimi për pacientët që mos të presin në radhë. Është bërë një modernizim i shërbimeve shëndetësore", ka deklaruar ministri Ismaili. Ai ka theksuar se në ambulancat specialistike kërkohen shumë shërbime, andaj ato duhet të jenë moderne dhe me kualitet të lartë. "Uroj për pacientët e Gjilanit të kenë një ambient mjaft të mirë për marrjen e shërbimeve", është shprehur ai.

Ndërkaq drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka thënë se hapja e ambulancave specialistike në Spitalin e Përgjithshëm të Gjilanit ka qenë premtim i vitit të kaluar në kuadër të ShSKUK-së. "Në ambulancat e reja është bërë digjitalizimi si dhe janë krijuar kushtet më komode për punë. Kjo do të jetë ndihmesë e madhe ku ofrohen shërbimet shëndetësore sekondare cilësore. Falënderoj Ministrinë e Shëndetësisë për përkrahje të të gjithave projekteve!", ka thënë Sejdiu.



KEK-u ka bërë përgatitjet e nevojshme për sezonin dimëror

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që gjatë sezonit të dimrit mos të ketë ndërprerje të energjisë elektrike. Kjo siguri ka ardhur në bazë të rezervave të mjaftueshme të thëngjillit dhe riparimit të blloqeve që mos të ketë rënie të tyre. Kështu ka thënë drejtori i KEK-ut, Njazi Thaçi, gjatë një takimi me kryetarin e Odës Ekonomike, Berat Rukiqi. Thaçi e ka siguruar Ukiqin se të

gjitha bizneset që janë konsumatore të mëdha, e që janë të lidhura me rrjetin e transmisionit, do të kenë mundësi që energjinë elektrike të marrin nga KEK-u. "KEK-u ka bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme që sezonin dimëror të kalojë sa më mirë të jetë e mundshme. T'i respektojë gjitha marrëveshjet kontraktuale që i ka me aktorët e tjerë. Kemi rezerva të mjaftueshme të thëngjillit, prandaj dimrin do ta kalojmë pa problem. Po ashtu, i kemi bërë të

gjitha përpjekjet e mundshme që riparimet e blloqeve të kryhen me kohë më të hershme në mënyrë që në sezonin e dimrit mos të kemi rënie të blloqeve si deri më tash. Po ashtu, diskutuam edhe për shumë çështje që lidhen me bizneset, siç është mundësia që konsumatorët e mëdhenj që janë të lidhur në rrjetin e transmisionit të kenë mundësi që energjinë elektrike të marrin nga KEK-u. U pajtuam bashkërisht që këtë çështje të

ngritim në organet relevante që merren me këtë çështje. Po ashtu, si pikë diskutimi ishte edhe çështja e mundësisë që bizneset tona të kenë mundësi që stafin e vet të vijnë ta trajnojnë në qendrën e trajnimit në KEK", ka deklaruar ai. Ndërsa kryetari i Odës Ekonomike, Berat Rukiqi, duke folur për nevojën e energjisë elektrike të bizneset, tha se në këtë sezon dimëror ato nuk do ta ketë këtë problem. "Oda

Ekonomike ka mundësi që të ketë partneritet mes Odës, KEK-ut, sektorit privat dhe komunitetit të donatorëve që e përkrahin vendin për ta fuqizuar dhe avancuar punën e qendrës së trajnimeve e cila është një prej qendrave më moderne në rajon sa iu përket mundësive për trajnim dhe certifikim të fuqisë punëtore, sidomos për fushat që ne kemi tash nevojë tek industria e metaleve, sektori i energjisë, ndërtimi dhe kështu me radhë", u shpreh Rukiqi.



Mirëpritet iniciativa për përmirësimin e integritetit të ATK-së

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka vazhduar edhe të premten konsultimet publike me bizneset, odat ekonomike, shoqatat, shoqërinë civile, mediat, donatorët dhe institucionet publike, të cilat janë duke u mbajtur për t'i paraprirë hartimit dhe zbatimit të Planit për Përmirësimin e Integritetit të Administratës Tatimore të Kosovës.

Ky plan ka për qëllim t'i identifikojë fushat që kontribuojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në ambicinet e menaxhmentit për përmirësimin e efikasitetit dhe të integritetit të ATK-së. Hartimi i këtij plani është duke u mbështetur nga programi i USAID-it për qeverisjen ekonomike në Kosovë, që njëherësh është edhe bashkorganizator i procesit të konsultimeve publike. Këto tryeza konsultative ishin të



rëndësishme për ndërtimin e dialogut të strukturuar të parë të këtij lloji për ta inkurajuar kontributin publik për t'i përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien e ATK-së. Rreth 100 pjesëmarrës kanë dhënë rekomandimet e tyre lidhur me pritshmëritë për integritetin e ATK-së. Drejtori i ATK-së, Ilir Murtezaj,

në tryezën e së premtes me odat dhe përfaqësuesit e bizneseve, ka pohuar se ATK-ja ka arritur përparim të mirë në përmirësimin e shërbimeve të saj për tatimpaguesit/zyrtetarët, duke mundësuar kryerjen e shërbimeve elektronike, përfshirë këtu deklarimin elektronik të tatimeve dhe ofrimin e shërbimeve të shumta

përmes platformave elektronike, optimizmin e proceseve të brendshme, siç janë procedurat e rimbursimit të TVSh-së dhe është në proces të prezantimit të ndryshimeve në strukturën e saj institucionale për një menaxhim më efektiv të funksioneve kryesore.

Po ashtu, drejtori Murtezaj ka folur edhe për matjet e institucioneve ndërkombëtare, me ç'rast ka thënë se perceptimi i publikut për përfshirjen e zyrtarëve tatimorë në korrupsion është nën mesataren rajonale. Sipas raportit të SELDI-t, 57 për qind është mesatarja e perceptimit për zyrtarët tatimorë në rajon, ndërsa 43 për qind perceptimi për zyrtarët tatimorë në Kosovë. Megjithatë, përmirësimet më të nevojshme që ATK-ja të bëhet një shembull prijës në mesin e institucioneve publike që ofrojnë shërbime të

cilësisë më të lartë për qytetarët. Sipas raportit të Asistencës Teknike (AT) të FMN-së për "Planin Afatmesëm për Forcimin e Performancës së Administratës Tatimore" nga shtatori i vitit 2018, perceptimi publik rreth ATK-së është që institucioni konsiderohet si një organizatë profesionale, megjithatë rezultatet e hulumtimeve të njëpasnjëshme sugjerojnë se ekzistojnë mundësi për përmirësimet. Ndërkaq përfaqësuesit e Programit të USAID-it për Qeverisje Ekonomike në Kosovë kanë thënë se për rritjen ekonomike, të shtyrë nga sektori privat, besimi mes ATK-së dhe tatimpaguesve është thelbësor. Palët e interesit e mirëpritën këtë nismë dhe u potencua se një komunikim i tillë në mes të ATK-së dhe sektorit privat duhet të jetë i vazhdueshëm.

Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) ka iniciuar procedurat e likuidimit për institucionin mikrofinanciar "IuteCreditKosovo" Sh. A. dhe për IFJB "Monego"

BQK-ja mbyll 'IuteCreditKosovo' dhe 'Monego'-n

Dy institucionet mikrofinanciare "IuteCreditKosovo" dhe "Monego" janë mbyllur nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për shkak se normat e interesit që kanë aplikuar këto institucione kanë qenë jashtë çdo standardi në raport me normat e interesit në kredi që aplikohen nga institucionet e tjera financiare në vend. Guvernatori i BQK-së, Fehmi Mehmeti, ka thënë se këtyre dy institucioneve u është tërhequr leja sepse kanë aplikuar norma shumëfish më të larta për kredi sesa kanë paraqitur në planin e biznesit. Ndërkaq të gjithë personat që kanë marrë kredi te këto dy institucione mikrofinanciare duhet t'i kryejnë obligimet, por që ky proces do të jetë nën përkujdesjen e BQK-së



EPOKA E RE | Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), duke u bazuar në kompetencat që i garanton neni 36, paragrafi 1, nënparagrafët 1.11 dhe 1.12, si dhe neni 67, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, si dhe në pajtim me nenin 105, paragrafi 1, nënparagrafi 1.10 të Ligjit për Bankat, Institucionet Financiare dhe Institucionet Financiare Jobankare, ka vendosur

që ta revokojë regjistrimin dhe t'i iniciojë procedurat e likuidimit për institucionin mikrofinanciar "IuteCreditKosovo" Sh. A. dhe për institucionin financiar jobankar "Monego".

Vendimin e Bordit Ekzekutiv të BQK-së e ka arsytuar të premten, në një konferencë për media, guvernatori Fehmi Mehmeti. "Përmas politike të saj të licencimit BQK-ja në vazhdimësi synon që të ofrojë kushte sa më të mira për qasje në financa në Kosovë, duke mundësuar operimin në tregun tonë financiar vetëm

të institucioneve të cilat i kontribuojnë stabilitetit dhe zhvillimit të sistemit financiar dhe, rrjedhimisht, edhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Mbi këtë bazë, BQK-ja kishte licencuar edhe dy institucionet e lartpërmendura të cilat në dokumentacionin përmas të cilit kishin aplikuar dhe në bazë të të cilit ishte dhënë licenca për të operuar në Kosovë, kishin ofruar planet e

tyre se si planifikojnë ta zhvillojnë veprimtarinë e tyre në Kosovë. Sidoqoftë, gjatë këtyre viteve të operimit në tregun tonë këto institucione në vazhdimësi kanë devijuar nga planet e tyre të biznesit në bazë të të cilave kishin marrë licencat për të operuar në Kosovë, duke i sjellë kështu tregun tonë diçka tjetër prej asaj që kishin premtuar që do të sjellin", ka thënë ai.

Mehmeti ka theksuar se devijimi më i rëndësishëm dhe më shqetësues nga planet e tyre të biznesit, në bazë të të cilave kishin marrë licencën, ka të bëjë me normat e interesit që këto institucione kanë aplikuar në kredi, të cilat, sipas tij, kanë rezultuar të jenë shumëfish më të larta në krahasim me normat që këto institucione kishin paraqitur në dokumentacionin e aplikimit për kredi, i cili paraqet një element shumë të rëndësishëm në procesin e marrjes së vendimit për aprovimin e licencave për institucionet financiare. "Normat e interesit që kanë aplikuar këto institucione janë jashtë çdo standardi, qoftë nëse i krahasojmë me vetë projektionet e këtyre institucioneve, qoftë në raport me normat e interesit në kredi që aplikohen nga institucionet e tjera financiare në vend", ka thënë ai.

Guvernatori Mehmeti ka thënë se BQK-ja në vazhdimësi është përpjekur që përmes masave të paraadministrative t'i shtyjë këto institucione që t'i adresojnë këto probleme, por ato nuk kanë rezultuar të suksesshme për shkak të mosgatishmërisë së këtyre institucioneve për t'i ndërmarrë korrigjimet e nevojshme. "Për këtë arsye, ne vlerësojmë se këto institucione kanë dështuar t'i sjellin tregun tonë rezultatet e pritura dhe, përkundrazi, me veprimtarinë e tyre kanë rrezikuar aftësinë

paguese të huamarrësve dhe me këtë kanë paraqitur rrezik edhe për stabilitetin financiar të vendit.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës është e përkushtuar të krijojë kushte për rritjen e konkurrencës së shëndoshë në tregun tonë financiar, duke mundësuar një konkurrencë të drejtë ndërmjet institucioneve financiare të cilat sigurojnë rritje të qasjes në financa dhe përmirësim të kushteve të qasjes në financa, por nuk do të lejojë asnjëherë operimin e atyre institucioneve të cilat nuk zbatojnë kërkesat rregullative dhe ligjore të vendit dhe të cilat shfrytëzojnë kushtet e vështira financiare në të cilat mund të gjendet një pjesë e popullsisë tonë, duke sjellë shërbime të cilat i varfërojnë edhe më tepër dhe e vështirojnë edhe më tepër jetën e tyre", është shprehur ai.

Po ashtu, guvernatori Mehmeti ka theksuar se janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që ka BQK-ja edhe në raport me sigurinë kombëtare të vendit. "Prandaj ne mbetemi të përkushtuar që në kuadër të fushës sonë të përgjegjësisë, në bashkëpunim me të gjitha autoritetet e tjera relevante, të mos lejojmë asnjë aktivitet që mund ta cenojë sigurinë tonë kombëtare", ka deklaruar Mehmeti.

Ndërkaq zëvendësguvernatori i BQK-së, Sokol Havolli, ka sqaruar se ka pasur mospërputhje të të dhënave para dhe mas marrjes së licencës sa iu përket normave të interesit për kredi.

"IuteCreditKosovo" dhe "Monego" ishin institucione financiare që ofrojnë kredi të shpejta konsumuese. Në Kosovë operojnë 23 institucione mikrofinanciare, me 183 njësi në nivel vendi. Norma efektive e interesit për kredi, sipas Bankës Qendrore të Kosovës, është 20.3 për qind.



Çfarë do të ndodhë me personat që i kanë borxh "IuteCreditKosovo"-s dhe "Monego"-s?

Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, gjatë konferencës për media ka bërë me dije se te këto institucione vetëm është dërguar likuidatori i cili do ta administrojë këtë proces. "Janë revokuar licencat dhe është

emëruar likuidatori që sot veçse ka shkuar në zyrat e këtyre institucioneve, i cili do ta bëjë procesin e likuidimit. Gjegjësisht, vendimmarrësit e këtyre institucioneve do t'i kthejnë kreditë te likuidatori, i cili do të jetë personi përgjegjës

për ta administruar procesin e likuidimit të institucioneve në fjalë", ka treguar Mehmeti. Pra, të gjithë personat do t'i paguajnë kreditë e tyre normalisht, proces që do të jetë nën përkujdesjen e Bankës Qendrore të Kosovës.

Ferizaj, komunë model për bashkëpunimin me MAPL-në dhe AKK-në

FERIZAJ, 6 DHJETOR (ER) - Shtimi i ndërveprimit në mes të Komunës së Ferizajt, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK) ishte temë e bisedës ndërmjet kryetarit të Ferizajt, Agim Aliu, i cili ka pritur në takim sekretaren e MAPL-së, Rozafë Ukimeraj dhe kryeshefin ekzekutiv të AKK-së, Sazan Ibrahim.

Në këtë takim Aliu shoqërohej nga drejtori i Urbanizmit dhe Mjedisit, Lulzim Aliu, drejtori i Pronës, Gjeodezisë dhe Kadastrës, Sabri Murseli dhe drejtori i Infrastrukturës, Arbër Bytyçi. Me këtë rast, Aliu i ka njoftuar mysafirët me të arritu-

rat që ka shënuar Komuna e Ferizajt në shumë segmente të qeverisjes lokale si dhe për sfidat që e kanë përcjellë ekzekutivin e legjislativin gjatë këtij gjysmë-mandati qeverisës.

Ai ka falënderuar MAPL-në dhe AKK-në për mbështetjen e vazhdueshme për adresimin e kërkesave të pushtetit tonë lokal. "Komuna e Ferizajt ka një raport të shkëlqyeshëm bashkëpunimi me institucionet e lartpërmendura që ka sjellë si rezultat përfitimin e granteve të ndryshme dhe instalimin e praktikave më të mira me qëllim të rritjes së efikasitetit të shërbimeve komunale", ka njoftuar Komuna e Ferizajt.



Shoqata 'Kuvajti' ndihmon 250 familje në Malishevë

MALISHEVË, 6 DHJETOR (ER) - Komuna e Malishevës ka një bashkëpunim të mirë me Shoqatën "Kuvajti" për bamirësi, Zyra në Kosovë. falë këtij bashkëpunimi të gjatë dhe miqësor janë ndihmuar 250 familje në asistencë sociale me nga një pako ushqimore. Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj dhe drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Liridon Hoti, janë shprehur falënderues për udhëheqësit e shoqatës së

"Kuvajti" për këtë ndihmë për qytetarët me asistencë sociale. Ndërsa përfaqësuesit e shoqatës "Kuvajti", Zyra në Kosovë, janë shprehur të gatshëm që herë pas here dhe sipas mundësive t'u dalin në ndihmë familjeve që kanë nevojë. Ata kanë theksuar se do ta vazhdojnë bashkëpunimin me institucionet përkatëse komunale. Edhe familjet që kanë pranuar këto pako ushqimore janë shprehur mirënjohëse për mbështetjen që janë duke marrë nga shoqata "Kuvajti".



Fillojnë punimet për asfaltimin e rrugës Këpuz - Mrasor

KLINË, 6 DHJETOR (ER) - Në fshatin Mrasor të Klinës kanë filluar punimet për asfaltimin e rrugës që lidhë këtë fshat me Këpuzin, projekt i cili po realizohet në kuadër të investimeve për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Për ta parë nga afër ecurinë e punimeve, kryetari i Klinës, Zenun Elezaj, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të komunës,

kanë qëndruar në Mrasor, ku janë pritur nga banorët të këtij fshati. Elezaj ka uruar qytetarët për fillimin e këtij projekti, i cili do ta lehtësojë qarkullimin rrugor dhe ka theksuar se projekte të tilla do të realizohen edhe në vitin tjetër në lokalitete të ndryshme, me qëllim të përmirësimit të infrastrukturës rrugore. Ndërsa qytetarët kanë falënderuar kryetarin për

realizimin e këtij projekti që, sipas tyre, është shumë i rëndësishëm për banorët e këtyre fshatrave dhe shton sigurinë në qarkullim. Asfaltimi i kësaj rruge me gjatësi prej 3 917 metrash, e cila financohet nga Ministria e Infrastrukturës, ka vlerë buxhetore prej 298 634 eurosh, ndërsa afati kohor për përfundimin e punimeve është 90 ditë pune.



Komuna e Gjilanit shpërndanë 35 krerë lopë për fermerë

GJILAN, 6 DHJETOR (ER) - Tridhjetepesë (35) familje bujqësore të Gjilanit kanë përfutur të premten nga një krerë lopë qumështore të racës "holl-shtajn-frizes", si pjesë e bashkëpunimit të Komunës së Gjilanit dhe Organizatës për Zhvillim Rural "Mëshqerra". Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, e ka falënderuar drejtoreshën e kësaj organizate, Florentina Kida-Gërguri, për këtë bashkëpunim trepalësh, duke thënë se qëllimi kryesor është që ta rrisin fondin e bagëtive.



"Bazë për zhvillimin ekonomik lokal është bujqësia dhe shtimi i fondit të bagëtive është një prej prioriteteve tona. Me këtë ne po i ndihmojmë dhe po e lehtësojmë punën e çdo familje bujqësore në Gjilan për zhvillim të kësaj veprimtarie. Ju sigurojmë se edhe në vitin e ardhshëm do ta zhvillojmë këtë projekt", ka thënë Haziri. Ai ka theksuar se Gjilani në parametrat e zhvillimit lokal ekonomik këtë vit po përmendet si komunë që është duke e zhvilluar industrinë e bujqësisë, përkatësisht për-

punimin e mishit. Ndërsa drejtoresha e Organizatës për Zhvillim Rural "Mëshqerra", Florentina Kida-Gërguri, e ka falënderuar drejtorin e Bujqësisë, Ramiz Ramadani, për të cilin ka thënë se vazhdimisht ka bërë përpjekje për ta përfutur këtë donacion. Projekti në fjalë kapë vlerën prej 100 mijë eurosh. Komuna e Gjilanit ka participuar me 28 mijë euro, me 59 mijë euro donatori dhe me 14 mijë euro fermerët.

Metamorfoza pas tërmetit: Nga tepsia te tepsia



Prof. Lisen BASHKURTI

Tërmeti i 26 nëntorit 2019 goditi rëndë Shqipërinë, mbarë shoqërinë shqiptare, sikundër edhe themelet e shtetit. Të gjithë aktorët dhe faktorët shoqërorë ndihen në një gjendje posttraumatike. Konfuzioni po dominon kudo. Turbullira e qeverisjes dhe paqartësia e opozitës, hallakatja e institucioneve dhe çoroditja e burimeve njerëzore. Qarjet vertikale dhe krisjet horizontale duket që kanë prekur çdo cep të vendit, por edhe të njeriut shqiptar.

Në fakt, Shqipëria prej kohësh është në një gjendje paratërmetore. Luhatjet ekonomike, paqëndrueshmëria sociale, kriza politike, mosfunksionimi i institucioneve, shprehin të gjitha së bashku një gjendje paratërmetore. Tërmeti fizik i 26 nëntorit 2019 vetëm që ekspozoi nga thellësitë e nëntokës së Shqipërisë dobësitë që ekzistojnë prej kohësh në mbិតokën e saj.

Tërmeti fizik zbuloi kalbëzimin sistematik dhe sektorial të vendit dhe përshpejtoi rënien e fallsiteteve, mashtrimeve, krimeve e korrupsionit e, si i tillë, ndihmoi edhe ato që nuk kishin sy për të parë, veshë për të dëgjuar dhe mend për ta kuptuar, krizën e ngrirë në të cilën ndodhej vendi prej kohësh. Kriza tërmet ekspozoi qartësisht krizën shtet. Posttërmeti po shoqërohet edhe me valë krizash të tjera, ose pas goditje tërmetore mbarëshoqërore. Këto valë patologjike shoqërore po marrin trajta të përcudnuara, të cilat po shpalosen me sjellje të ndryshme kontradiktore, nga dhimbja te tallja, nga tragjika te komikja, nga racionalja te çmenduria, nga e besueshmja te mashtrimi, nga humania te kriminalja, nga ndjeshmëria te brutaliteti, nga fakti te propaganda. Po bëhet tejet e vështirë për ta vënë kufirin ndarës midis këtyre sjelljeve kontroverze. Le t'i përmendim disa prej tyre...

1. Të pafajshmit fajësohen, fajtorët lavdërohen

Tërmeti është dukuri natyrore, nga më të rëndat dhe më të paparashikueshmet. Si një dukuri e tillë askush nuk mund të fajësohet për goditjet e tërmetit. Por, tërmetet, siç do dukuri natyrore të paparashikueshme, shkaktojnë pasoja të ndryshme, varësisht nga shkalla me të cilën shoqëria dhe shteti janë përgatitur për t'u përballur me to.

Përvoja tregon se edhe tërmete shumë të rënda kanë shkaktuar dëme të pakta, kur shoqëria dhe shteti kanë qenë të mirëpërgatitur për t'u përballuar me to. Sikundër ka ndodhur që edhe tërmete jo aq të rënda kanë shkaktuar pasoja katastrofale, kur shoqëria dhe shteti nuk kanë qenë të përgatitur për t'u përballur me to. Madje, në këtë kuptim edhe tërmete të së njëjtës fuqi goditëse kanë shkaktuar pasoja të ndryshme në shoqëri dhe shtete të ndryshme. Përvoja në Shqipëri provoi se edhe brenda një mjedisi të vogël e të njëjtë gjeografik e sizmik tërmeti solli pasoja krejtësisht të ndryshme mbi njerëz dhe objekte të ndryshme. Nuk është tërmeti që e bën këtë seleksionim, por është shteti pa standarde që e shkakton atë.

Për deduksion mund të themi se shoqëritë dhe shtetet nuk mund të parashikojnë dhe parandalojnë tërmetet, së paku deri më sot, por ato çka ato mund dhe duhet të bëjnë është që të parapërgatiten dhe t'i përballojnë sa më mirë pasojat e tyre. Këtu qëndron dilema e kohës sonë. Shoqëria dhe shteti shqiptar u ekspozuan jo mjaftueshmërisht të përgatitur, për të mos thënë u gjenden mjaftueshmërisht dobët përballë fatkeqësisë natyrore.

Duke u ekspozuar në këtë mënyrë përpara fatkeqësisë natyrore, shoqëria dhe shteti duket se pas tërmetit kanë dalë nga shinat e të arsyeshmes, të drejtës dhe të dobishmes. Pikërisht në momentin kur duhet të flasin njerëzit e thjeshtë, të dëmtuar dhe të traumatizuar, që janë viktimat e kësaj fatkeqësie, mediat,

ekranet, gazetat po mbushen me figura të stërnjohura dhe të bajatshme shtetërore, politike dhe institucionesh publike, qendrore dhe vendore.

Dhe, çfarë është më e çuditshme, në gojë të tyre të liga dhe injorante nuk dëgjon apologji, përlulje, reflektim, autokritikë, përgjegjësi por, përkundrazi, dëgjon një fjalomani të pafund, që tenton t'i mbulojë me propagandë të zhurmshme fajtorët e vërtetë të shumë problemeve që ekspozoi tërmeti.

Është e trishtueshme të shohësh këto ditë përballjet midis viktimave dhe fajtorëve, përballje në të cilat viktimat duken të tërhequra e mjerane, ndërkohë që fajtorët shfaqen tejet agresivë dhe krenarë. Kjo sjellje paradoksale është për të vënë duart në kokë, sepse në thelb vret shpresat për ndryshim...

2. Flasin ato që duhet të heshtin dhe heshtin ato që duhet të flasin

Në këto çaste është koha që të flasin gojë të urta, njerëzit e mendjes, ekspertët, teknikët, drejtësia, gazetarët, sepse situata kërkon një reflektim dhe investigim të plotë dhe të thellë. Nuk mund të ringrihet vendi sërish mbi gërmadhat e padrejtësive, diletantizmit, krimin e korrupsionit.

Mirëpo, ajo çka po shohim këto ditë është proeliksiteti i pafund i atyre që duhet të vihen përpara përgjegjësive penale dhe civile dhe mbyllja e gojës me forcë, me prangosje, me shantazhime të fshehta apo fyerje të hapura të atyre që kanë çfarë thonë dhe duhet ta thonë publikisht.

Është tërësisht e papranueshme që në këtë periudhë të trishtë, nën arsyetimin e 'shmangies së panikut' të mbyllen gojë gazetarësh dhe mediash, të ndalohen në paraburgime, të detyrohen të largohen nga vendi, të kërcënohen ekspertë e teknikë, të shantazhohen juristë me dije dhe përvojë.

Gojë të liga dhe injorante nuk po i lënë as në këto momente krize të thellë gojë të urta dhe profesionale që të shprehen publikisht. Arsyetimi i censurës së përbindshme 'për mosng-

jallje paniku' është sa i dhimbshëm aq edhe qesharak. Është i dhimbshëm, se kur ndodh tragjedia, kur njerëzit janë varrosur, kur qytetarët kanë humbur gjithçka, kur mijëra veta duhet të nisin jetë nga e para, paniku nuk përbën kurrfarë shqetësimi për to.

Kur ndodh tragjedia, kur njerëzit janë varrosur, kur qytetarët kanë humbur gjithçka, kur mijëra veta duhet të nisin jetë nga e para, paniku i vërtetë i pushton shkaktarët kryesorë të kësaj situatë krize, ato që duhet të vihen përballë drejtësisë, ato që nevojitet që t'i paguajnë dëmet civile, ato që kërkohet të dorëhiqen një minutë e më parë. Nuk është paniku publik, por vetë paniku politik që po tenton t'i hapë gojë të liga dhe injorante dhe t'i mbyllë gojë të urta e profesionale.

Arsyeja themelore përse gojë të liga dhe injorante duan t'i censurojnë gojë të urta dhe profesionale është sepse këto të dytë po kërkohen me insistim reflektim dhe investigim, përpara rindërtimit, kërkesa këto që gojë të liga dhe injorante duan t'i shtypin me çdo kusht, me censurë e propagandë, me presion dhe shantazhim.

Refleksioni i thellë dhe investigimi i plotë janë dy parakushtet që të nxirren përgjegjësitë dhe përgjegjësitë e shumë problemeve të dala nga tërmeti. Nga ana tjetër, ndryshimi që kërkohet duhet të fillojë me një ringritje të re, mbi filozofi e vizione të reja, mbi modele e koncepte të reja, mbi institucione e kapacitete njerëzore tërësisht të ndryshme nga ato të para tërmetit.

Nuk mundet ai që hapë plagët t'i shërojë ato. Nuk mundet që etërit e krimin e korrupsionit të mafies ndërtime të bëhen rindërtuesit e një ere të re. Nuk mundet fajtorët ta bëjnë viktimën. Nuk mundet shkatërrimtarët të sillen si fitimtarët. Nuk mundet që dështakët të lozin triumfatorët. Nëse kjo do të ndodhte atëherë do të kishim një riciklim të tranzicionit me gjithë paçavuret që e kanë karakterizuar, atëherë 'tërmete' të shumta të çfarëdolloj natyre edhe më të fuqishme do ta godisnin Shqipërinë dhe shoqërinë shqiptare.

Është momenti që tërmeti i 26 nëntorit të shërbejë si një vijë ndarëse përfundimtare midis tranzicionit plot kaos, babëzije, trukime, falsitete, padrejtësi, mungesë përgjegjësie dhe stabilitetit bazuar në sundimin e ligjit, integritetit moral, profesionalitetit, transparencës, përgjegjshmërisë politike dhe publike.

Në një kohë të tillë priten të vërtetat e mëdha dhe jo mashtrimet e paskrupullta. E reja ngrihet mbi të vërtetë, kalbësirat ngrihen mbi mashtrime. Reflektimi dhe investigimet duhet të ngrihen mbi viktimat dhe gërmadhat e tërmetit. Në fakt, po tentohet që mbi viktimat dhe gërmadhat e tërmetit të ringrihet kadavra e ndryshkur e propagandës së vjetër dhe të dalë bojë.

Është e tmerrshme dhe tërësisht e papranueshme që t'i ndjekësh këto ditë përballjet publike e mediatike midis shkaktarëve të tranzicionit të tejzgatur plot kaos, babëzi, trukime, fallsitet, padrejtësi, papërgjegjshmëri dhe njerëzve të mendjes, ekspertëve, teknikëve, juristëve, gazetarëve, që kontribuojnë prej kohësh për t'i dhënë fund kësaj situatë mjerane të vendit. Kjo përballje me sjellje paradoksale midis atyre që duhet të heshtin dhe atyre që duhet të flasin duhet të marrë fund njëherë e përgjithmonë dhe të varrosët së bashku me tërmetin e 26 nëntorit 2016 që goditi Shqipërinë dhe shqiptarët.

Epilogu, një lider dhe një imam

Shqipëria u godit tragjikisht nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Dhjetëra të vdekur u larguan nga kjo botë, qindra të plagosur po lëngojnë pasojat e gërmadhave, mijëra të pastrehë e të dëmtuar përjetojnë dilemën e nisjes së jetëve nga e para...

Përkundrazi kësaj skene të trishtë, të dhimbshme dhe të shëmtuar po na shpalosen në ekrane skena groteske me liderë politikë dhe imamë fetarë, me humanistë e bamirës, me tepsia dhe tepsia!

Mosdodhtë që historia shqiptare ta përsërisë atë që ndodhi 500 vjet më parë, që politika dhe islami të bashkohen në shariah, sepse do të dështonin të dyja, e bashkë me to edhe gjithë Shqipëria dhe shqiptarët...

Komuna e Skenderajt përfiton nga GIZ-i gjerman 614 shporta për mbeturina

SKENDERAJ, 6 DHJETOR (ER) - Në kuadër të ofrimit të shërbimeve më të mira për qytetarët, Komuna e Skenderajt ka përfutuar 614 shporta për mbeturina 120 litra nga GIZ-i gjerman. Lajmin e ka bërë me dije

kryetari i kësaj komune, Bekim Jashari. "Këto shporta do të shpërndahen në mënyrë proporcionale në fshatrat e komunës tonë, duke shtrirë rrjetin e ofrimit të shërbimeve sa më shumë për qytetarët. Me

veprime të tilla do të përpiqemi t'i zvogëlojmë deponitë ilegale me disa investime në makineri për grumbullim të mbeturinave", ka thënë Jashari, i cili ka falënderuar GIZ-in gjerman për këtë donacion.



Recension

Një vepër me vlera për themeltarët e Albanologjisë

(Hazir MEHMETI, "STUDIUES AUSTRIAKË E SHQIPTARË NË AUSTRI - Në gjuhë, art dhe kulturë", Lena, Prishtinë, 2019)

Bedri TAHIRI

Studiuesi për studiuesit e dalluar

Një vepër hulumtuese me karakter antologjik mbi studiuesit austriakë dhe shqiptarë në Austri nga fusha e gjuhësisë, artit dhe kulturës. Brumi i saj nga e kaluara në vepra personalitetesh të njohur për kombin shqiptar e më shumë. Në shekullin e kaluar Austria ishte qendër e njohur për historinë e kontinentit dhe kombeve të tij. Zhvillimi i arsimit dhe shkencës mundësoi edhe zhvillimin e lulëzimit të kulturës, tani e përjetësuar në vepra të shumta, të shkruara nga hulumtues të mëdhenj, të cilët Evropës i dhanë kuptimin dhe imazhin prijës civilizues në botë. Fatbardhësisht, edhe shqiptarët ishin në shënjestrën e penave të këtyre personaliteteve nga

fusha e historiografisë, gjuhës, artit, shkencës dhe kulturës. Vjena ishte njëra nga qendrat ku dallohet me vepra të shumta e me rëndësi, lidhur me shqiptarët nga studiues gjermano folës dhe më vonë, në dhjetëvjetëshit e tretë, dhe të katër studiues shqiptarë. Rrethanat e rënda në territoret shqiptare nuk lejuan njohjen e këtyre personaliteteve, vlerësimin e tyre. Tani, në mesin e atyre që do merret me mbledhjen dhe studimet rreth veprimtarisë së atyre që studiuuan në Austri, iu shtua, publicisti, studiuesi e krijuesi i palodhur, autori i librit në shqyrtim "STUDIUES AUSTRIAKË E SHQIPTARË NË AUSTRI- në gjuhë, art dhe kulturë", z. Hazir Mehmeti.

Në këtë vepër kushtuar studiuesve dhe krijuesve në Austri lidhen dy kohë veprimtarësh me të gjitha kontradiktat brenda hapësirës me bazë Epokën e Lindjes së Alfabetit,



Mr. sci. Hazir Mehmeti me shkrimtarin austriak Peter Paul Wiplinger

duke vazhduar me pavarësinë dhe përpjekjet për themelimin e institucioneve të mirëfillta të shteti dhe në ndërtimin e tij.

Një Enciklopedi e llojit të vet

Libri "Studiues Austriakë e Shqiptarë në Austri, në gjuhë, art dhe kulturë", shikuar hollë e hollë, paraqet një lloj enciklopedie shumë të vlefshme, me të dhëna të nevojshme e me fotografi, që pasqyrojnë bindshëm jetën dhe veprimtarinë e personaliteteve më të shquara që folën shqip në Austri, siç reflekton edhe vetë titulli.


Si moto të librit janë vënë thëniet lapidarë të tre kolosëve tanë: Fan Noli, Naim Frashëri dhe Gjergj Fishta si dhe fjala përshëndetëse e ambasadorit të Shqipërisë në Austri, z. Roland Bimo, i cili shprehet: "Thuhet se çdo gjuhë është një dritare e hapur për njohjen e botës... Përmes kësaj dritareje arritën të shohin albanologët e mëdhenj austriakë të vërtetën mbas mjegullave të historisë. Ishin Gustav Majer, Johan Georg fon Han, Miklošić, Lybke, Jireček, Shuflai, Karl Paç dhe Baroni Nopça, fillimisht duke hulumtuar shqipen, të

cilët themeluan, argumentuan dhe mbrojtën etnogjenezën ilire të shqiptarëve.

Nga ana tjetër, janë me dhjetëra filologët e gjuhëtarët shqiptarë që janë formuar në Klagenfurt, Grac e Vjenë, duke filluar nga Gjergj Pekmezi, Hilë Mosi, Karl Gurakuqi e deri tek Lasgush Poradeci e i madhi Eqrem Çabej- të gjithë shembuj frymëzimi për mijëra studentë shqiptarë që sot shkollohen në Austrinë mike, si edhe

për fëmijët shqiptarë të lindur e rritur në këtë vend, mbështetja e të cilit është sprovuar gjatë historisë sonë të trazuar.

Duke e shfletuar, lexuar e shijuar kujdesshëm librin e Hazir Mehmetit "STUDIUES AUSTRIAKË E SHQIPTARË NË AUSTRI- në gjuhë, art dhe kulturë" bindemi plotësisht se ai, vërtet, është një enciklopedi e llojit të vet, nga i cili mund të informohesh e të mësosh për



Autori i librit me Prof. dr. Eqrem Zenelaj, Vjenë, nëntor 2019



Autori i librit me Sir. Noel Malcolm, Vjenë, janar 2016

DOLI NGA SHTYPI LIBRI "STUDIUES AUSTRIAKË E SHQIPTARË NË AUSTRI" NGA VEPRIMTARI, VETERANI I ARSIMIT SHQIP NË AUSTRI DHE AUTOR I SHUMË BOTIMEVE Mr. sci. HAZIR MEHMETI

HAZIR MEHMETI

STUDIUES AUSTRIAKË E SHQIPTARË NË AUSTRI
(Në gjuhë, art dhe kulturë)

Norbert Jokl

Hilë Mosi

Lasgush Poradeci

Xhevat Korça

Eqrem Bej Vlora

Marie (Paluca) Kraja

Aleks Buda

Eqrem Zenelaj

Efqem Çabej

Gjergj Pekmezi

Pandeli Sotiri

Leopold Berchtold

Ismail Kemal Vlora

Lena

PRISHTINË, 2019

shumëçka. Autori i rryer e me përvojë, Hazir Mehmeti, me një mjeshtri të rrallë ka arritur ta mbarështrijë mirë e mbarë gjithë atë mal faktesh: biografi, dokumente, fotografi, materiale arkivore, shkrime nga shtypi etj., të grumbulluara për gjashtë vjet rresht, duke e sistemuar e konceptuar në disa kapituj, të ndërlidhur me njëri-tjetrin, si mishi me thoin.

Në kapitullin e parë, që më shumë shërben si një hyrje, jepen në mënyrë telegrafike informacionet për shqiptarët në Austri, për shkollimin e tyre atje dhe ndikimi i austriakëve në çështjen shqiptare.

Kapitulli i dytë shpërfaq qartë e natyrshëm kontributin e pazëvendësueshëm të germanofolësve për gjuhësinë shqiptare, duke nisur që me

Arnold Fon Harffin, autorin e dokumentit të dytë i gjuhës shqipe, për të vazhduar me Johannes Thunman, Jakob Philipp, Fallmerayer, Johannes Georg von Hahn, Gustav Meyer, Leo Freundlichm Franz Baron Nopcsa, Jan Urban Jarnik, Norbert Jokl, Maximilian Lambertz, Franc Xaver Ritter Miklosich, Theodor Ippen Herman M. Ölberg Wilfried Fiedler e Dr. Kurt Goschtenshinnig etj.

Ndërkaq në kapitullin e tretë mund të mësojmë për personalitete të njohura austriake me origjinë shqiptare, siç ishin: Gjergj Basta, Karl Gega e Aleksandër Moisiun, me të cilët krenohet edhe e gjithë bota e civilizuar.

Thelbin e librit në shqyrtim, padyshim, e përben kapitulli i

katërt, ku pasqyrohet jeta dhe veprimtaria e mbi njëqind personaliteteve të mëdhenj shqiptarë në Austri, në mesin e të cilëve shquhen Hasan Prishtina, Kolë Rrota, Gjergj Pekmezi, Efqem Çabej, Aleks Buda, Hilë Mosi, Lasgush Poradeci, Karl Gurakuqi, Kristë Maloku, Skënder Luarasi, Pandeli Sotiri, Xhevat Korça, Sokrat Dodbiba, Efqem bej Vlora, Marie Kraja, Aleks Buda, Efqem Zenelaj e shumë e shumë të tjerë, deri tek studiuesit e shkencëtarët e ditëve tona, ku u dallua edhe vajza e autorit e nxënësja ime, Dr. Vlora Mehmeti- Tërshani, tashmë e ndjerë.

I rëndësishëm dhe mjaft interesant na del edhe kapitulli i fundit "Shoqëritë shqiptare në Austri", ku, në

mënyrë përmbledhëse e të argumentuar pasqyrohet jeta kulturore e veprimtaritë e begata të shoqërive, revistave, gazetave, gramatikave, klubeve, organizatave e shoqatave prodhimtare shqiptare në Austri. Në kuadër të këtij kapitulli është futur edhe një shtojcë plotësuese me emrin "Dromca nga shtypi i kohës, kushtuar figurave të prezantuara në libër", të cilat janë shkëputur nga botimet e mëhershme nëpër revista e gazeta të ndryshme nga vetë autori i librit.

Dhe, e gjithë kjo punë do të dilte e zbehtë fare, po mos të shfrytëzoheshin edhe foto të ndryshme, të cilat autori Hazir Mehmeti i ka për zemër. Nëse gjithmonë është thënë: Një foto flet sa një mijë fjalë, atëherë, del se libri "STUDIUES AUSTRIAKË E SHQIPTARË NË AUSTRI- në gjuhë, art dhe kulturë", paskësh vlerë të madhe dhe, po del se paskësja pasur të drejtë kur, që në fillim, e quajta një Enciklopedi e llojit të vet!

Në përmbyllje, autorit i dëshirojmë shëndet e suksese të mëtejme në fushën e krijimtarisë e librit mirëpritje nga lexuesit dhe bibliotekat tona!

Të dhëna për autorin

Hazir Mehmeti u lind në Besnik (ish Beçiq) Kosovë. Është pedagog, autor dhe publicist, është anëtar i Akademisë Pedagogjike të Tiranës. Që nga viti 1996 jeton në Austri kur i njihet nënshtetësia mbi baza të përndjekurit politik. Është anëtar i Asociacionit Ndërkombëtar të Gazetarëve Botërorë, Lidhjes së Shkrimtarëve e Krijuesve Shqiptarë "Aleksandër Moisiu"

në Austri dhe Diasporës në Gjermani. Nga Akademia Pedagogjike e Tiranës është botuar monografi për te me titull: "Mësues e Krijues në Diasporë".

Përveç aktivitetit mësimor merret edhe me publicistikë. Artikujt e tij e gazetaresk e hulumtues janë botuar në dhjetëra gazeta e revista shqiptare në Kosovë, Shqipëri e Maqedoni dhe vende tjera. Është bashkëpunëtor i disa gazetave dhe revistave letrare në mërgatë dhe Atdhe. Ai është nismëtar në themelimin e e faqës së internetit dhe përgjegjës i saj për gjuhën shqipe (Schule-mehrsprachig) pranë Ministrisë së Mësimin të Austrisë. Është autor i Abetares së parë shqipe në Austri, botuar nga Ministria e Mësimin e Austrisë. Abetare e standardeve të larta bashkëkohore. Gjithashtu, Haziri, është bashkautor i 19 teksteve mësimore për fëmijët në diasporë nga projekti i Prof. Dr. Basil Schader i mbështetur nga Ministria e Arsimit Shkencës e Teknologjisë e Kosovës. Hazir Mehmeti ishte pjesë e projektit mbi metodologjinë me tekstet e reja, filmime didaktiko metodike u shfaqen në shumë seminare në disa vende.

Nga fusha letrare ka botuar: Shëngjergji dhe tregime tjera; Kohëthyerja, tregime. Në gjermanisht, Zertrüerung der Zeit, e botuar nga PEN. Klubi Austriak Ka fituar në tri konkurse letrare në Austri dhe Zvicër, vendet e para në prozë, në njërin fiton vendet e para në prozë dhe poezi. Nga Klubi letrar "Rifat Kukaj", vlerësohet për vitin 2018 me çmimin "Krijues i vitit në diasporë".

Autori i këtij shkrimi është recenzionisti dhe botuesi i librit



Pheniani paralajmëron gjuhë fyese ndaj Presidentit Trump

PHENIAN, 6 DHJETOR - Koreja e Veriut paralajmëroi të premtën se do të përdorë sërish gjuhë ofenduese për të përshkruar presidentin amerikan Donald Trump nëse ai vazhdon të provokojë Phenianin.

Paralajmërimi u bë nga zëvendësministria e Punëve të Jashtme të Koresë së Veriut Choe Son Hui, ndërkohë që po shihen shanset e rifillimit të negociatave për armët bërthamore dhe programet e raketave balistike të Koresë së Veriut.

Gjatë javëve të fundit, Koreja e

Veriut ka sugjeruar se do t'i rifillojë testimet bërthamore dhe të raketave me rreze të gjatë, nëse Shtetet e Bashkuara nuk bëjnë lëshime përpara fundit të vitit në negociatat bërthamore.

Presidenti Trump u shpreh të martën gjatë një takimi të NATO-s në Londër se ai ka një marrëdhënie "vërtet të mirë" me udhëheqësin koreanoverior Kim Jong Un, por i bëri thirrje atij të përbushë angazhimet e ndërmarra për çnuklearizimin. Presidenti Trump gjithashtu tha se Kimit "i pëlqen të lëshojë raketa" dhe shtoi se prandaj unë

e quaj njeriu-raketë.

Choe tha se nëse komentet e presidentit Trump në Londër synonin të rikthenin qëllimisht në kujtesë periudhën e dy viteve më parë kur u zhvillua një luftë fjalësh mes dy vendeve, atëherë kjo do të jetë një sfidë shumë e rrezikshme.

Presidenti Trump tha gjithashtu të martën se Shtetet e Bashkuara janë "pa asnjë krahasim, vendi më i fuqishëm në botë dhe të shpresojmë që nuk do të na duhet ta vëmë në përdorim ushtrinë. Por, nëse do të duhet, do ta përdorim".



Merkel në Aushvic: Thellësisht e turpëruar nga krimet gjermane

Në vizitën e parë të saj në Aushvic, në një kohë kur Gjermania po shënon një ringjallje të antisemitizmit dhe rritje të elementeve të krahut të djathtë, kancelarja Angela Merkel ka thënë se ndjen turp të madh ndaj mizorive gjermane të kryera në kampin e vdekjes në Aushvic, gjatë Luftës së Dytë Botërore

BERLIN, 6 DHJETOR - Kancelarja gjermane, Angela Merkel, vizitoi të premtën, ish-kampin nazist në Aushvic, për herë të parë në 14 vitet e saj si kancelare.

Vizita e Merkelit bëhet në një kohë kur Gjermania po shënon një ringjallje të antisemitizmit dhe rritje të elementeve të krahut të djathtë.

Merkel është kancelarja e tretë gjermane që vizitoi ish-kampin në Poloni.

Udhëtimi i saj është jashtëzakonisht simbolik, pasi bëhet para shënimit të 75-vjetorit të çlirimit të këtij kampi nga trupat sovjetike më 27 janar 1945.

Merkeli mbajti një minutë heshtje

në "Murin e vdekjes", vendin ku mijëra të burgosur të kampit u qëlluan për vdekje.

Gjatë fjalimit të saj - pasi vendosi kurora lulesh në ish-kampin e afërt Birkenau - Merkeli tha se ndjen "turp të madh" ndaj mizorive gjermane të kryera në kampin e vdekjes në Aushvic, gjatë Luftës së Dytë Botërore.

"Ndihej thellësisht e turpëruar nga krimet barbare të kryera këtu nga gjermanët. Këto ishin krime që shkuan përtej asaj që mund të imagjinohet", tha Merkeli, ka njoftuar rfe.

Merkeli theksoi nevojën për të kujtuar atë që ka ndodhur në Aushvic, edhe pse, siç tha, tmërri i



këtij krimi e lë atë pa fjalë.

"Por, heshtja nuk është përgjigje", tha Merkeli, duke nënvizuar gjithashtu nevojën për të kujtuar se gjermanët ishin fajtorë dhe se është e rëndësishme që autorët të identifikohet qartë.

"Ne ia kemi borxh këtë viktimitave dhe vetvetes", tha Merkeli.

Ajo gjithashtu tha se nuk do të ketë tolerancë ndaj antisemitizmit në Gjermani dhe Evropë, duke bërë thirrje për luftimin e antisemitizmit kudo.

Në prag të udhëtimit të saj, Merkeli tha se "lufta kundër antisemitizmit dhe kundër të gjitha formave të urrejtjes" ishte përparësi për qeverinë e saj.

65-vjeçja premti gjithashtu vendosmëri nga qeveria për të mundësuar që jeta e hebrenjve të lulëzonte në Gjermani.

"Vizita është një sinjal veçanërisht i rëndësishëm i vëmendjes dhe solidaritetit, në një kohë kur të mbijetuarit e Aushvicit janë viktima të fyerjeve anti-semitike dhe postimeve në rrjete sociale të cilat janë të mbushura me urrejtje", tha Christoph Heubner, nënkryetar i Komitetit Ndërkombëtar të Aushvicit.

Përpara udhëtimit të Merkelit në Poloni, Gjermania miratoi një donacion prej 60 milionë eurosh për Fondacionin Aushvic-Birkenau.

Merkeli u shoqërua nga kryeministri polak, Mateusz Morawiecki dhe një i mbijetuar i kampit.

Josef Schuster, kreu i Këshillit Qendror të Hebrenjve në Gjermani dhe Ronald Lauder, kreu i Kongresit Botëror të Hebrenjve, gjithashtu morën pjesë në këtë vizitë.

Një milion hebrenj u vranë në Aushvic-Birkenau, së bashku me 100,000 polakë jo-hebrenj, robër të luftës nga ish-Bashkimi Sovjetik, romë dhe luftëtarë tjerë antinazistë.

Merkeli e ka quajtur Holokaustin një "ndarje me civilizimin" dhe ka shprehur shqetësimin për ngritjen e anti-semitizmit në Gjermani.



Turqia do të blejë më shumë raketa nga Rusia

ANKARA, 6 DHJETOR - Rusia dhe Turqia po punojnë për një kontratë të re të shitblerjes së sistemeve raketore ruse S-400, raporton agjencia e lajmeve Interfax.

Moska shpreson të nënshkruajë një marrëveshje për të furnizuar Turqinë me më shumë sisteme S-400, në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm, ka konfirmuar më 23 tetor,

eksportuesi shtetëror rus i armëve, Rosoboronexport. Uashingtoni e ka pezulluar Ankarën nga programi i aeroplanëve luftarak F-35, në të cilin Turqia ishte një prodhues dhe blerës.

Zyrtarët ushtarakë të ShBA-së dhe NATO-s kanë kundërshtuar prej kohësh blerjen e sistemit të Rusisë nga Turqia, duke thënë se nuk ishte në për-

puthje me sistemet ushtarake të aleancës dhe do të rrezikonte avionët e rinj F-35 të përdorura nga Perëndimi.

Një zyrtar i lartë i Departamentit amerikan të Shtetit ka paralajmëruar sanksione kundër aleatëve amerikanë, Turqisë dhe Egjiptit, për marrëveshjet ushtarake që këto vende kanë lidhur me Rusinë.



'Vdekja më vjen prej syve të tillë' e Rexhep Qosjes tashmë edhe në gjuhën italiane

PRISHTINË, 6 DHJETOR (ER) - Romani "Vdekja më vjen prej syve të tillë" i Rexhep Qosjes është botuar në Itali. Deri tani ky roman ka qenë i përkthyer në shtatë gjuhë.

Romanin në gjuhën italiane e ka përkthyer Anila Alhasa dhe e ka botuar shtëpia botuese "Egnatia".

"Vdekja më vjen prej syve të tillë" (1974) është romani i parë post-modern i letërsisë shqipe dhe ndër veprat më të bukura të letërsisë sonë. Ismail Kadare, në parathënien që ia ka bërë botimit frëngjisht të këtij romani, thotë:

"Rexhep Qosja është shkrimtari më i madh ndër shqiptarët që jetojnë jashtë kufijve të vendit, të cilët përbëjnë më shumë se gjysmën e kombit shqiptar (...) 'Vdekja më vjen prej syve të tillë' është një vepër me inspirim kafkian, një roman që prish qetësinë, një vepër që profetizon apokalipsin dhe një nga veprat më të mëdha të letërsisë shqiptare". Ndërsa kritika

franceze Rexhep Qosjen e ka quajtur Volter i Ballkanit dhe Kafka i Lindjes. Kritiku italian Anselmo Roveda shkruan se "Rexhep Qosja është një ndër mjeshtrit më të mëdhenj të letërsisë ballkanike dhe nismëtari i një tradite të re letrare shqiptare". Një kohë e shtrirë, të paktën në fillim, gati e varur dhe e lidhur fort me një botë antike plot legjenda e besime, nganjëherë edhe me paragjykimë; një kohë që bëhet më pas më e shpejtë, e përpiktë, herë pas here klaustrofobike dhe dramatikisht afër së tashmes.

Një vend imagjinari, i largët por edhe qendror, unik; një qytet provincial por që është edhe kryeqendër për shoqërinë që e konsideron pikë referimi, politik e kulturor.

Një kohë e një vend letrar pas së cilës fshihen, pa u ruajtur edhe shumë, një kohë dhe një vend real: një qytet shqiptar, aq krenar sa edhe i shtypur, në Jugosllavinë e shekullit të kaluar, pak a shumë



mes viteve 1950 e 1970.

Në këto koordinata kohe e vendi, gjejmë Xhezairin e Gjikës, njeri i letërsisë dhe i aspiratave të mëdha, dhe Danjollin e Sherksë, persekutues mendjengushtë, eksponent i policisë politike.

I pari është i izoluar dhe peng i ëndrrave të veta dhe i rrethanave në cilat ndodhet, i dyti, edhe pse

është më shumë ngjallës frike se i respektuar, ka një pozicion të spikatur në shoqëri. Fatet e tyre të kundërta, e bashkë me to edhe fatet e shumë banorëve të Vajazanit, të cilat popullojnë romanin, gërshetohen dhe më pas ndërthuren me fatet e të një shoqërie të tërë përpara historisë. Lind kështu një vepër letrare e vullshme dhe turbulluese; vetëm në dukje drejtuar anës private dhe individuale, përmes ngjarjeve e lidhjeve edhe dashurore të Xhezairit; sepse, më pas, i tërë romani kthehet në një afresk social, në gjendje të nxjerrë në pah nga fat i një individi të veçantë, elemente të së përgjithshmes, deri edhe jashtë dimensioneve të kohës dhe të vendit. Pa u futur kësaj radhe në detaje të analizës së veprës e të veprimtarisë së autorit do të gjeni mendime të rëndësishme rreth këtyre (në fund të librit) duhet theksuar që ky objekt letrar jo i zakonshëm një seri tregimesh që mund ose më mirë, duhen lexuar

së bashku, si një roman prezanton një fortesë (dhe një kryevepër) të letërsisë shprehëse shqiptare; ashtu si edhe autori i saj, Rexhep Qosja, prezanton një nga mjeshtrit e letërsisë ballkanike, nismëtar i një tradite të re letrare në letërsinë shqiptare.

Lexusi italian do të mundet më në fund ta shijojë prozën e tij; një mënyrë tregimi që na sfidon nëpërmjet forcës së tematikave dhe të vetë strukturës së romanit, duke iu referuar vazhdimisht debateve kulturore dhe me gjuhën e tij të kërkuar dhe letrare, të rrallë e të vullshme, që është në gjendje të alternojë regjistrat e gjuhës e në fund të përfshijë shumëllojshmërinë e formave të gjuhës - edhe falë dialogjeve, shprehjeve të mendimeve, krijimit të fjalëve të reja dhe ridimensionimin e leksikut, të shkronjave, të ëndrrave... Do të jetë një mundësi për të zbuluar një shkrimtar të çmuar në rang ndërkombëtar e për t'iu afruar kështu një klasiku të pashmangshëm të letërsisë shqiptare.

Fotografja suedeze hapi ekspozitën me 50 fotografi

Pas katër dekadash, fotografja suedeze Ann Christine Eek rikthehet me ftesë të Galerisë së Ministrisë së Kulturës për ta hapur ekspozitën personale me 50 fotografi lidhur me jetesën shqiptare në fshatin Isniq të Deçanit

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Në vitet '70, në një fshat të Kosovës, një fotografe suedeze fokusoi punën e saj në jetesën e shqiptarëve, duke shkrepur kështu fotografi të cilat do të ekspozoheshin në Galerinë e Ministrisë së Kulturës, pothuajse 40 vjet pas realizimit të tyre.


Të enjten në mbrëmje zyrtarisht u hap ekspozita "Jeta në fshatin shqiptar. Isniq, Kosovë, 1976", ekspozitë kjo që kishte për qëllim ta vinte në pah mënyrën e jetesës të shqiptarëve, e kryesisht të

grave, në Kosovën e viteve '70.

50 fotografi bardh e zi kishin mbushur muret e galerisë, 50 jetë shpaloseshin para dashamirësve të fotografisë dhe jo vetëm. Në mesin e të pranishmëve kishte edhe persona që kishin qenë protagonistë të fotografes Eek.

Fotografja Ann Christine Eek për herë të parë vizitoi Kosovën në vitin 1976 dhe qëndroi për gati shtatë javë në fshatin Isniq, bashkë me antropologjen Berit Backer. Këto dyja po punonin në një projekt që kishte për bazë

zhdukjen e jetës tradicionale në fshat, duke realizuar kështu disa mijëra fotografi bardh e zi. Fokusuan punën e tyre në tregimet e pesë grave të fshatit. Në fotografitë e varura në muret e galerisë varehin jetët e shumë grave shqiptare që ishin bërë protagoniste kryesore në punën e fotografes Eek. Në fotografi gratë e fshatit Isniq ishin kapur tekta zienin, punonin me bagëti, kujdeshin për fëmijët, punonin në vek etj.



Themelohet Çmimi Letrar 'Adem Demaçi'

Prishtinë, 6 dhjetor (ER) - Kryesia e Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës (LShK) ka marrë vendim për themelimin e çmimit të ri letrar me emrin e shkrimtarit, politikanit dhe atdhetarit Adem Demaçi, që do të jepet

çdo vit më 5 mars në akademinë letrare-artistike "Ora e Lirisë" për krijimin më të mirë të paraqitur në këtë veprimtari të LShK-së që organizohet në kuadër të Ditës së Dëshmorëve të Lirisë.

E rrallë

Prezantohet makina e parë fluturuese në botë

Makina e parë në botë që fluturon bëri debutimin e saj në ShBA. Automjeti i quajtur Pioneer Personal Air Landing, ose PAL-V, u prezantua në Miami. PAL-V është konsideruar makina e parë fluturuese në botë. Çmimi i makinës është 599 000 dollarë. Kompania që prodhon PAL-V tha se tashmë janë shitur 70 vetura.



FOTO E DITES



Një djalë dhe një vajzë shkëmbejnë shikime në një kamp në veri të provincës veriperëndimore Idlib. /AFP/

E jashtëzakonshme

Qeni vendos rekord, sjell në jetë në mënyrë natyrale 21 qenushë

Një qen britanik ka lindur 21 këlyshë në mënyrë natyrale dhe raportohet se ka vendosur rekord të ri botëror. Kur Joanne Hine zbuloi se qeni i saj Mary Jane (MJ) ishte mbarës i thanë se mund të lindte deri në gjashtë këlyshë. Por kur erdhi data



e lindjes MJ tregoi se, në fakt, numri i qenushëve ishte shumë më i lartë. Ajo lindi 21 këlyshë shumë afër rekordit botëror Gines të vendosur në vitin 2004 nga Tia.

BARSOLETA E DITËS



Burrë e grua flasin për pushimet por, para se të vendosin, e shohin nëse kanë buxhet. Pasi e analizojnë buxhetin, burri thotë:
- Valla unë nuk kam nevojë për pushime, se nuk jam aspak i lodhur.
Gruaja:
- Valla as unë, se po ndihem shumë në formë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC


Vetëm gjatë vikendit në ora 13:00

The Addams Family / 3D

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 orë 27 min

Rolet: Oscar Isaac, Charlize Theron, Chloë Grace Moretz, Finn Wolfhard, Nick Kroll, Bette Midler, Allison Janney, etj.

Regjia: Conrad Vernon And Greg Tiernan



Çdo ditë në ora 15:00 dhe 17:00

FROZEN 2 / 3D

I Animuar/Aventure/Komedi; 1 orë 43 min

Rolet: Kristen Bell, Idina Menzel, Josh Gad, Jonathan Groff, Jason Ritter, etj.

Regjia: Chris Buck, Jennifer Lee



Çdo natë në ora 19:00

FORD V FERRARI

Aksion/Biografi/Dramë; 2 orë 32 min

Rolet: Matt Damon, Christian Bale, Jon Bernthal, Caitriona Balfé, Tracy Letts, Josh Lucas, Noah Jupe, Remo Girone, Ray McKinnon, etj.

Regjia: James Mangold



Çdo natë në ora 21:30 TERMINATOR DARK FATE

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 2 orë 14 min

Rolet: Linda Hamilton, Arnold Schwarzenegger, Mackenzie Davis, Gabriel Luna, Natalia Reyes, Diego Boneta, Edward Furlong, etj.

Regjia: Tim Miller



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, [fb: Kino ABC](https://www.facebook.com/kinoabc).



DASHI

Është mirë të mos komentoni


shumë idetë tuaja tek persona që sapo i keni njohur. Asnjëherë nuk do të dini se si po i përdorin.



DEMI

Sot do t'ju duhet të jepni prova për

altruizmin tuaj, sidomos në raportet familjare. Do të hiqni dorë nga një gjë që e keni mjaft për zemër.



BINJAKËT

Keni kohë që jeni bërë viktimë të

konformizmit. Nëse gjërat do të ndryshojnë sot do të jetë një ndryshim për mirë.



GAFORRJA

Është një çështje që ju shqetëson

prej kohësh dhe sot ka ardhur çasti t'i jepni fund. Gjithë ky shqetësim do të duket sikur s'ka ekzistuar.



LUANI

Ka projekte që ju kanë zënë

shumë nga koha juaj dhe që do të kuptoni që nuk mund të realizohen. Filloni mbani distancë përpara se të jetë vonë.



VIRGJËRËSHA

Kontaktet që keni krijuar gjatë

karrierës suaj do t'ju ndihmojnë të merrni një vendim që po e shtyni prej kohësh. Çdo gjë do të shkojë mirë.



PESHORJA

Nëse nuk doni ta humbni mbështetjen e personave pranë

jush duhet të jeni më i pranishëm në jetën e tyre dhe t'i mbështesni në çdo hap.



AKREPI

Keni kohë që keni qëndruar në të njëjtin

vend pa bërë hapa përpara. Kjo gjendje po ju bën të ndiheni keq dhe të mbylleni në vetvete.



SHIGJETARI

Keni zgjedhur mënyrën më të mirë

për të qenë vërtet të lumtur. Jeni të mbushur me optimizëm këtë periudhë dhe kjo ju ka ndihmuar.



BRICJAPI

Kohët e fundit keni qenë mjaft të

zënë me jetën tuaj private duke lënë pas dore impenjimet profesionale. Mund të krijohë ngecje në karrierë.



UJORI

Sot mund të merrni vendime

shumë të ndryshme nga sa keni thënë më parë. Kjo sepse në çdo çast do të keni ndryshime të situatave.



PESHQIT

Keni guxuar më shumë

sesa që duhet këtë periudhë dhe sot do të jetë momenti që do t'ju duhet të merrni mbi vete të gjitha përgjegjësitë.

Leo DiCaprio në festë deri në 6:00 të mëngjesit me Kendall Jennerin



Leo DiCaprio pati festë deri në lindjen e diellit. Burimet thanë se DiCaprio shkoi te megaklubi "E11even" rreth orës 4:30 duke hyrë nga një hyrje private. Ylli iu bashkua VIP-ve të listës A, përfshirë Kendall Jennerin, Gigin dhe Bella Hadidin.

Në këtë festë ishin rreth 50 veta në tavolinën e Leos, përfshirë edhe Helly Nahmad. Grupi u pa duke pirë vodka dhe disa orë më pas Leo u pa duke dalë jashtë me dy djem, ndërsa Jenneri dhe klika e saj dolën një gjysmë orë më vonë.

Taylor Swifti thotë që stresin dhe nervozen do t'i largojë nga jeta



Këngëtarja e njohur Taylor Swift ka thënë se do ta lëmbrapa stresin para ditëlindjes së 30. Ajo këtë e bëri me dije në një intervistë për "People". "Ka disa pjesë të trurit tim që nuk i vizitoj aq shpesh, si stresi rreth trupit tim, stresi rreth

asaj se a do të jem trendi, stresi rreth asaj se çka mendojnë njerëzit për mua. Duhet t'i flak gjakrat që nuk shërbejnë më. Unë mendoj se ne të gjithë tekna jemi duke u bërë më të vjetër duhet të bëhemi më të mençur dhe të mos mendojmë për këto gjëra", ka thënë Swifti.



Rita Ora falënderon adhuruesit për dëgjimet që i mori në "Spotify"

Këngëtarja e njohur me prejardhje nga Kosova, Rita Ora, i ka falënderuar të gjithë adhuruesit për dëgjimet që ka marrë në platformën muzikore "Spotify" pasi "Spotify" së fundi ka publikuar sta-

tistikat vjetore për secilin këngëtar, duke treguar numrin e dëgjimeve që ata kanë shënuar përgjatë vitit 2019. Ora këtë vit është dëgjuar mbi një miliard herë nga plot 84.7 milionë njerëz në mbarë botën.

Halsey e thyen hundën



Këngëtarja e njohur Halsey e ka thyer hundën. Sipas "Daily Mail", këngëtarja këtë e bëri të ditur me anë të postimeve në rrjetin

social "Facebook". Këngëtarja nga New Jersey nuk ka treguar arsyen se si e ka thyer hundën, por vetëm ka thënë se e ka thyer.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Emimi: Ballkani, skuadër e fortë, por kualifikohet Trepça '89

Leart Emini për "Epokën e re" ka shprehur optimizëm se Trepça '89 do të jetë në gjendje të eliminojë Ballkanin nga Kupa, i cili në stinorin vjeshtor ka qenë në formë të jashtëzakonshme. "E përgëzoj Ballkanin që u shpall kampion vjeshtor sepse e ka merituar, por shpresoj dhe besoj se ne do ta vazhdojmë raundin tjetër të Kupës", ka thënë Emini. Optimizëm për kualifikim ka shprehur edhe mbrojtësi i Ballkanit, Besnik Krasniqi



ÇIFTET E 1/8 SË KUPËS

Të shtuan takohen:
Ballkani - Trepça '89
Drenica - Dardana
Feronikeli - A&N
Vitia - Dukagjini

Të dielën takohen:
Arbëria - Prishtina
Trepça - Vushtrria
Liria - Ferizaj
Gjilani - 2 Korriku
(Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 12:30)

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Sot (e shtunë) nga ora 12:30 zhvillohen katër ndeshje të 1/8 së finales së Digitalb Kupës së Kosovës në Futboll. Ndeshja kryesore do të jetë ajo në mes të Ballkanit dhe Trepçës '89 e cila zhvillohet në Suharekë. Një nga lojtarët më të mirë në klubin nga Mitrovica, Leart Emini, ka thënë të premtën për "Epokën e re" se skuadra e Ballkanit është e fortë dhe e vështirë për t'u mposhtur si

vendës, por '89-shi do të jetë ajo skuadër që kualifikohet në raundin tjetër. "Do të jetë lojë e vështirë për të dyja skuadrat dhe është keq kur në këtë fazë njëra skuadër duhet të eliminohet. Ballkani ka një skuadër të fortë dhe është vështirë të mposhtet, sidomos në Suharekë, por ne jemi të koncentruar në lojën dhe filozofinë tonë, çka kemi dëshmuar edhe më herët se Trepça '89 mund ta mposhtë secilën skuadër dhe nuk mund të quhet befasi. E përgëzoj Ballkanin që u shpall kampion vjeshtor sepse e

ka merituar, por shpresoj dhe besoj se ne do të vazhdojmë në raundin tjetër të Kupës", ka thënë Emini.

Optimizëm për ndeshjen që zhvillohet sot ka shprehur edhe mbrojtësi i Ballkanit, Besnik Krasniqi. Ai ka paralajmëruar se në këso ndeshje nuk lejohen gabimet, kurse maksimumi nga liderët e elitës, sipas Krasniqit,

nuk do të mungojë për ta arritur objektivin. "Do të jetë një ndeshje shumë e fortë ndaj një skuadre mjaft të mirë siç është Trepça '89. Është një ndeshje dhe gabimet nuk falen, pasi nuk do të ketë vend për përmasime. Duhet të jemi të vëmendshëm të bëjmë sa më pak gabime dhe ta japim maksimumin ndaj tyre në mënyrë që të kalojmë tutje", ka

thënë Krasniqi. Ndeshje interesante sot (e shtunë) do të zhvillohet në Skenderaj, ku Drenica e pret Dardanën nga Kamenica, kurse Feronikeli është favorit ndaj A&N dhe në ndeshjen e tretë përballen Vitia dhe Dukagjini. Të dielën zhvillohen katër ndeshjet e tjera në 1/8 së finales së Kupës në futboll, pastaj skuadrat do të shkojnë në pushim dimëror.

Bashkimi, për fitore edhe ndaj Pejës

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Sot (e shtunë) dhe nesër (e diele) do të zhvillohet xhiroja e 16 e Superligës së Kosovës në basketboll. Ndeshja e parë e kësaj xhiroje do të zhvillohet ndërmjet Lipjanit dhe Feronikelit. Lipjanasit kërkojnë fitoren e parë në Superligë në këtë edicion, kurse skuadra nga Drenasi në edicionin e parë në elitë synon të jetë pjesë e Superligës, kurse deri më tani ka grumbulluar 16 pikë, ndërsa Lipjani ka 14. Sfidë shumë interesante pritet të jetë ajo ndërmjet Bashkimit dhe Pejës. Prizrenasit hyjnë në këtë përballje pas fitores në derbin lokal ndaj Ponte Prizrenit dhe triumfit kundër Rahovecit, kurse pejanët pas rikthimit në elitë shpresojnë të rikthehen të fortë si më parë. Prizrenasit kanë 23 pikë, ndërsa pejanët tri pikë më pak. Përballje shumë interesante pritet të jetë ajo e të dielës ndër-



mjet Golden Eagle Yllit dhe Ponte Prizrenit. Therandasit janë në formë në xhirot e fundit dhe shpresojnë të vazhdojnë me fitore edhe kundër Prizrenit, që ka treguar lojëra të mira në stinorin vjeshtor, duke grumbulluar 22 pikë, kurse therandasit kanë një pikë më pak. Takimi i fundit i kësaj jave zhvillohet në mes të Trepçës dhe Sigal Prishtinës. Mitrovicasit ndodhen në vendin e tetë me 15 pikë, ndërsa prizrenasit në vendin e katërt me 21 pikë. Rahoveci do të pushojë në këtë xhiro.

SUPERLIGA - Java 16

Të shtunën takohen:
17:00 Lipjani - Feronikeli
19:00 Bashkimi - Peja

Të dielën takohen:
17:00 Golden Eagle Ylli - Ponte Prizreni
19:00 Trepça - Sigal Prishtina

'Dardanët': Mos na ndërprisni ëndrrën

PRISHTINË, 6 DHJETOR - Tifozët e Kosovës, "dardanët", kanë reaguuar pas zhvillimeve të fundit në Federatën e Futbollit të Kosovës. Kërkesa e këtyre tifozëve është që interesi i shtetit të Kosovës dhe futbollit të saj të jetë primar dhe mbi interesat individuale, çdo mosmarrëveshje të zgjidhet pa tensione dhe të mos e dëmtojë marrëdhënien e FFK-së me UEFA-n, por edhe mos të ketë ndërhyrje politike në FFK. "Dardanët", po ashtu, i kanë dhënë mbështetje kryetarit aktual të FFK-së, Agim Ademi. "Paradoksalisht, në vend se të jemi të fokusuar në ndeshjet e radhës të 'play-off'-it, ne dhe gjithë opinioni publik futboll-dashës jemi në ethe të ngjarjeve rreth FFK-së. U bëjmë apel të



gjithëve për ftohje të tensioneve që mund ta rrezikojnë pjesëmarrjen tonë eventuale në 'Euro 2020'. Ne, tifozët e Kosovës, nuk mbështesim asnjëherë individë të caktuar, por futbollin e Kosovës. Ne, tifozët e Kosovës, gjithmonë do t'i përkrahim strukturat legale në FFK, andaj e përkrahim kryetarin aktual të FFK-së, Agim Ademi. Ëndrra jonë vazhdon. Mos na ndërprisni", thuhet në reagimin e "dardanëve".

Në Gjakovë zhvillohet ndeshja derbi

Gjakovë, 6 dhjetor - Në fundjavë luhet xhiroja e 13-të e Superligës së Kosovës në Hëndboll (meshkujt). Ndeshja më interesante do të zhvillohet sot (e shtunë) në Gjakovë, kurse takohen Vëllaznimi dhe Kastrioti,

kurse ky takim fillon në orën 18:00. Vëllaznimi është i gjashti me 10 pikë, ndërsa ka treguar lojëra të mira së fundi. Ekipi gjakovar llogaritet edhe në përkrahjen e shikuesve për ndeshjen me skuadrën tjetër me traditë,

Kastriotin e Ferizajt. Kastrioti është i treti me 16 pikë sa i ka edhe Trepça në vend të katërt.

Të shtunën zhvillohen edhe përballjet Llapi-Vushtrria (19:00), Drenica-Prishtina (19:00) dhe Drita-Trepça

(18:30). Ndërsa të dielën nga ora 18:00 takohen Prizreni dhe Besa Famgas. Kampionia aktuale, Besa Famgas, i ka fituar 12 ndeshjet e deritashme dhe udhëheq në tabelë me 24 pikë. Prishtina është e dyta me 22 pikë.



Kosova, organizatore e Kampionatit Botëror në hendboll për universitete

Prishtinë, 6 dhjetor - Kosova do të jetë organizatore e Kampionatit Botëror në hendboll për universitete në vitin 2022. Lajmin e ka konfirmuar kryetari i Federatës së Sporteve Universitare të Kosovës, Musa

Selimi. "U konfirmua se Kosova dhe Federata e Sporteve Universitare e Kosovës morën lajmin e shumëpritur që do të jemi organizatorë të Kampionatit Botëror në Hendboll për universitete më

2022! Kjo ngjarje, më e madhja që ka pasur Kosova deri më tani, do të jetë sfidë për ne dhe komunitetin sportiv, Komunën e Prishtinës, qeverinë dhe tërë popullin tonë", ka thënë Selimi. Ndonëse federatë e re, FSUNK-ja

ka dëshmuar vullnetin dhe aftësinë e saj dhe të shtetit të Kosovës për të sjellë në vendin tonë një kampionat të rëndësishëm botëror, nën koordinimin e Federatës Ndërkombëtare të Sportit Universitar.



KB Ylli: Në Rahovec na shanë dhe sulmuan



SUHAREKË, 6 DHJETOR (ER) - Golden Eagle Ylli nëpërmjet një njoftimi për medie e ka akuzuar skuadrën e Rahovecit për mirëpritjen e bërë në ndeshjen që është zhvilluar të enjten. Skuadra nga Suhareka shënoi fitore por, sipas reagimit të saj një ditë pas ndeshjes, tifozët vendës në vazhdimësi kanë fyer lojtarët e Yllit. "Ndeshja e zhvilluar mbrëmë në Rahovec, përpos fitores së merituar, na la edhe shije të keqe nga tifozët vendës. Lojtarët tanë ishin gjatë gjithë kohës nën sharje dhe fyerje nga tifozët, por edhe nga ata që ishin ulur në prag të fushës. Aq më e turpshme ishte fyerja morale që bëhej ndaj neve në banerin e

tifozëve vendës. Pas përfundimit të pjesës së parë u hodhën edhe mjete piroteknike. Por, nuk përfundoi me kaq, edhe dy herë të tjera u hodhën mjete piroteknike. Me të përfunduar ndeshja me fitoren e klubit tonë, sikur në kor u hodhën shkrepëse, shishe plastike dhe gjësende të tjera në drejtim të lojtarëve tanë brenda fushës dhe në dalje të saj", thuhet në reagimin e skuadrës së Yllit. Klubi nga Suhareka, po ashtu, bën me dije se pas përfundimit të ndeshjes sulmet nuk munguan ndaj zyrtarëve të klubit dhe tifozëve, veturave të tyre dhe minibusit të lojtarëve. "Ata suharekas që erdhën ta shikojnë

ndeshjen, automjetet e tyre i gjetën me dëmtime. Mirëpo, jo vetëm kaq. Disa prej tyre u sulmuan tinëzisht. Sulmi u bë edhe mbi zyrtarët e klubit tonë. Veturat me regjistrim 04 kishin fatin e njëjtë, duke mos përfunduar as minibusin e lojtarëve. Kjo sjellje e keqe na dëshpëron thellësisht, kur mendojmë se ishte Rahoveci që në Suharekë, përpos që luajti në palestër, ishte i mirëpritur dhe pa asnjë dëmtim. Pas gjithë kësaj, neve festën e fitores nuk mundën të na zbehin, pasi kemi festuar herët. Edhe atëherë kur Rahoveci basketboll vetëm në televizor ka shikuar", thuhet në reagimin e Golden Eagle Ylli.

Houstoni mposhti Toronton

TORONTO, 6 DHJETOR - Katër sfida në mbrëmjen e NBA-s. Vëmendjen më të madhe e mori dueli i zhvilluar në "Scotiabank Arena" mes kampioneve në fuqi, Toronto Raptorsit dhe Houston Rocketsit. James Hardeni me shokë arritën një fitore të madhe në parketin e Torontos me shifrat 119-109. Dallimin nuk e bëri James Hardeni, por 26-vjeçari Ben McLemore, autor i 26 pikëve në këtë superduel. Një dorë gjithësesi në fitoren e 14 sezonale, Houstoni e mori edhe nga mjekroshi Harden, autor i 23 pikëve, 7 rikuperimeve poshtë tabelës dhe 3 asistimeve. Në krahun tjetër kanadezëve të cilët pësuan humbjen e 2-të rresht dhe të 6-n në 15 takime nuk u mjaftuan 24 pikët e kamerunasit Pascal Siakam. Në ndeshjet e tjera Washingtoni



kaloi me rezultatin 119-113 Philadelphia 76-ers, Denver Nuggets triumfoi në transfertë ndaj New York Knicksit me rezul-

tatin e thellë 129-92, ndërkohë që New Orleans Pelicansi u mposht pas kohës shtesë me rezultatin 132-139 nga Phoenix Sunsi.

SHKURT

Durmishi kalon te Nice

Futbollisti me origjinë shqiptare, Riza Durmishi, do të largohet nga Lazio në afatin kalimtar të janarit. 25-vjeçari do të transferohet te Nice për 6 muaj deri në përfundim të këtij sezoni. Marrëveshja është zyrtarizuar dhe Durmishi është prezantuar me fanellën e klubit të tij të ri. Skuadra e Nicës drejtohet nga Patrick Viera, kurse mbrojtësi i krahut do të ketë shumë më tepër mundësi aktivizimi dhe dëshira e Durmishit në këto çaste është të luajë rregullisht për t'u grumbulluar nga Danimarka në "Euro 2020".

Pogba pëlqen kalimin në Real para rikthimit në Juventus

Mesfushori i Francës, Paul Pogba, po planifikon të largohet nga Manchester Unitedi, derisa në garë për shërbimet e tij janë Juventus dhe Real Madridi. Asi francez po pëlqen kalimin në Real para rikthimit në Juventus, sipas medieve në Francë. "Zonja e Vjetër" është e interesuar ta rikthejë sërish mesfushorin të cilin e shiti në vitin 2016 për 105 milionë euro, kurse në anën tjetër Reali në verë e kaluar kishte tentuar vazhdimisht që ta transferonte në "Santiago Bernabeu" por, pa sukses.

Evertoni shkarkon trajnerin Silva

Humbja nga Liverpooli i ka kushtuar me shkarkim trajnerit të Evertonit, Marco Silva. Rezultatet e skuadrës nga "Goodison Park" në këtë edicion të garave janë shumë të dobëta, prandaj shkarkimi i trajnerit Silva ishte i pashmangshëm. Aktualisht Evertoni renditet në vendin e tetëmbëdhjetë me vetëm 14 pikë.

Michael Schumacheri zbulon synimet që ka në vitin 2020

Titulli kampion në Formula 2 në vitin 2020 dhe një vit më vonë, në vitin 2021, do të debutojë në Formula 1. Ky është objektivi i Mick Schumacherit, djalit të Michael Schumacherit, që edhe sezonin e ardhshëm do të garojë me makinën italiane Prema në Formula 2. "Ishte zgjidhja më logjike ajo që të garoja sërish në Formula 2 edhe vitin tjetër. Nuk ka për të qenë e lehtë, edhe pse me një vit më shumë përvojë, pasi ka shumë modifikime, por fakti që qëndrova aty është pozitiv për mua", ka thënë Mick Schumacher në një intervistë për "L'Equipe". Më tej, piloti 21-vjeçar foli për babanë e vet, shtatë herë kampion i botës. "Do të jetë gjithnjë më i miri. Ka qenë gjithnjë heroi im, sepse është babai im dhe një legjendë e Formulës 1. Nuk e di nëse do t'i ndjek gjurmët e tij. Kam vite që garoj, që nga kategoria katër, tani synoj vetëm të shkoj në Formula 1", ka deklaruar Mick Schumacher. Në fund, Mick shprehet se Formula 1 është objektivi i tij kryesor për të ardhmen. "Objektivi im është ai, por fillimisht dua titullin në Formula 2 sezonin tjetër. Kam provuar një makinë të këtij sezoni për vetëm dy ditë. Shpresoj që një ditë të kem një makinë timen aty", ka shtuar piloti i ri gjerman.

Chelsea mund të transferojë lojtarë në janar

Klubi anglez, Chelsea, është i lirë të transferojë futbollistë nga afati i ardhshëm kalimtar, pasi FIFA ka vendosur t'ia përgjysmojë dënimin. Chelsea është dënuar në shkurt nga FIFA me një ndalesë transferimesh për dy afatet e ardhshme kalimtare për shkeljen e rregullave rreth transferimit të të miturve. Dënimi i shqiptuar nga FIFA parashihte që "blutë" e Londrës të mos mund të transferojnë lojtarë në afatin e kaluar të verës dhe të dimrit. Megjithatë, tashmë është vendosur që atyre t'u përgjysmohet dënimi dhe ata do të jenë të lirë të transferojnë lojtarë nga muaji i ardhshëm. Është Gjykata e Arbitrazhit për Sport ka marrë këtë vendim. "Chelsea është e lirë të nënshkruajë me lojtarë nga janari pasi Gjykata e Arbitrazhit për Sport përgjysmoi ndalesën e transferimit të klubit", thuhet në njoftim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
Ministry of Infrastructure and Transportation

Në mbështetje të nenit 24 të Udhëzimit Administrativ (MI) Nr. 09/2015 Për Kycje Instalime nëpër Tokën Rrugore dhe për Shfrytëzim të Tokës së Rrugëve Nacionale dhe Rajonale, paragrafit 1.4 të nenit 3 dhe paragrafit 1.5 të nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.01/2014 Mbi Caktimin e Tarifave për Shfrytëzimin e Tokës së Rrugëve Nacionale dhe Rajonale, bënë:

SHPALLJE PUBLIKE Për dhënie të tokës me qira

Toka e evidentuar pjesë e parcelës kadastrale P-7211046-00278-0 në sipërfaqe të përgjithshme prej 9402m² në Zonën Kadastrale Suharekë, e cila pas shpronësimit në bazë të vendimit nr. 08/148 të datës 05.11.2010 dhe vendimit përfundimtar nr.06/12 të datës 27.04.2011 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pronë e Qeverisë së Republikës së Kosovës - Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit më seli në Prishtinë, jepet me qira vetëm për qëllime komerciale.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Informatën për regjistrin e biznesit;
- Certifikata e TVSH;
- Certifikata e Numrit Fiskal;
- Planin ekonomik të investimeve me një përshkrim të përgjithshëm për veprimtarinë afariste në tokën të marrë me qira, në të cilat specifikohen aktivitetet afariste, si dhe ndikimi i veprimtarisë në shtimin e numrit të punësuarave;
- Afatin e përdorimit të tokës për qiramarrje, në varësi të aktiviteteve afariste;
- Vërtetimin se nuk ka detyrime financiare ose ligjore të pashlyera ndaj shtetit;
- Nivelin e çmimit që ofron për marrjen me qira të tokës;
- Çmimi fillestar vjetor 0,30 cent për m²;
- Garancionin bankar për sigurimin e ofertës në vlerën e qirasë.

Kriteret:

- Të drejtë aplikimi kanë personat fizik dhe juridik, vendor dhe të huaj;
- Koha e shfrytëzimit të dhënies së tokës me qira është njëzet (20) vite, me mundësi vazhdimi;

Data e shpalljes: 06.12.2019

Data e mbylljes: 05.01.2020

Dokumentacioni:

- Kërkesa në formë të shkruar e plotësuar dhe nënshkruar nga ofertuesit, si dhe e protokolluar në Ministrinë së Infrastrukturës dhe Transportit;
- Letërnjoftimi;
- Kartela e bankës.

Dokumentet duhet të jenë të fotokopjuara, sepse ato nuk kthehen.

Procedurat e aplikimit: Kërkesat për aplikim për marrjen e tokës me qira dorëzohen në arkivin Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, Sheshi "Nëna Terezë", ish-ndërtesa e Gërmisë - Prishtinë.

Na osnovu člana 24. Administrativnog uputstva (MI) br. 09/2015 Za priključne instalacije na cestovnom zemljištu i za korišćenje zemljišta nacionalnih i regionalnih puteva, stavak 1.4 člana 3. i stavak 1.5 člana 4. Administrativnog Uredba Br.01/2014 O Utvrđivanju Tarifa za Korišćenje Zemljišta Nacionalnih i Regionalnih putevima, uradite:

JAVNI OGLAS Za iznajmljivanje zemljišta

Zemljište evidentirano deo katastarskoj parceli P-7211046-00278-0 na ukupnoj površini od 9402 m² na mestu zvanom Katastarska zona Suhareka, koje je nakon eksproprijacije, na osnovu odluke, br. 08/148 od 05.11.2010 i konačna odluka br. 06/12 od 27.04.2011. Vlada Republike Kosovo, je vlasništvo Vlade Republike Kosovo - Ministarstvo za infrastrukturu i transporta sa sedištem u Prištini, iznajmljeno samo u komercijalne svrhe.

Potrebna dokumentacija:

- Sertifikat o registraciji poslovanja;
- Informacije o poslovnom registru;
- Sertifikat o PDV;
- Sertifikat Fiskalnog broja;
- Ekonomski plan investicija sa opštim opisom o poslovnoj delatnosti u poljoprivrednom zemljištu pod zakup, u kojem se određuju poslovne aktivnosti, kao i uticaj delatnosti u povećanju broja zaposlenih;
- Trajanje korišćenja zemljišta u zakupu, zavisno od poslovnih aktivnosti;
- Potvrdu da nema neizmirenih finansijskih ili pravnih obaveza prema državi;
- Visinu ponudene cene za zakup poljoprivrednog zemljišta;
- Početna cena godišnji 0.30 cent za m²;
- Bankarska garancija za osiguranje ponude u vrednost zakupa.

Kriterijumi:

- Pravo na apliciranje imaju fizička i pravna lica, domaća i strana;
- Vreme korišćenja poljoprivrednog zemljišta datog na zakup je dvadeset (20) godina, sa mogućnošću produženja;

Datum objavljivanja: 06.12.2019

Datum zatvaranja: 05.01.2020

Dokumentacija:

- Zahtev u pisanoj formi popunjen i potpisan od strane ponuđača, kao i protokoliran u Kosovskom institutu poljoprivrede u Peći;
- Lična karta;
- Bankovna kartica.

Dokumenti treba da budu fotokopirani, jer se isti ne vraćaju.

Procedura apliciranja: Zahtevi za apliciranje za uzimanje zemljišta u zakup se dostavljaju Ministarstvu Infrastrukture i Transporta Trg Majke Terezije, bivša zgrada Germije - Priština.

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: "Bajram Curri" vendi Romaje
Komuna: Prizren
Data: 07.12.2019

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:Trajnim
ESIP/SDG/82 – CS/1.3	Puna e kujdestarit te klases-kujdestari i mire

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shfmu "Bajram Curri" Romajë, Prizren. Objektivi i nën-komponentit 1.2. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim; Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e dy kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe personelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjashme (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK). Firmat Konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: Shfmu "Bajram Curri" Romajë, Prizren, më së largu deri më datën: 17.12.2019 Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë:

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Refki Demaj
Telefoni: 044/113196
E-maili: refki-demaj@hotmail.com

Çmimet në fushën e Trashëgimisë

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në përputhje me Rregulloren NR.09/2016 për Dhënien e Çmimeve në fushën e trashëgimisë kulturore, shpall:

KONKURS

Për çmimet që i ndan Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në fushën e trashëgimisë kulturore. Ftohen të interesuarit që të propozojnë kandidatët për Çmimin për Veprimtari Jetësore në fushën e trashëgimisë kulturore “Dea Dardanicae”, Çmimin Vjetor për Merita të Veçanta “Shtjefën Gjeçovi”, Çmimin Vjetor për Vepër Shkencore “Zef Mirdita” dhe Çmimin Vjetor për Menaxhim Institucional “Muhamed Shukriu”.

Çmimi për Veprimtari Jetësore në Fushën e Trashëgimisë Kulturore “Dea Dardanicae”

Ky Çmim u jepet personaliteteve të shquara, profesionistëve të dalluar, të cilët me angazhimin e tyre të vazhdueshëm kanë pasur ndikim të drejtpërdrejtë në avancimin e trashëgimisë kulturore si dhe kanë nxitur të arriturat në mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

Çmimi Vjetor për Merita të Veçanta “Shtjefën Gjeçovi”

Ky Çmim u jepet personaliteteve të dalluara në fushën e trashëgimisë kulturore, për angazhimin, kontributin dhe të arriturat përgjatë vitit për përmbushjen e detyrimit kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore të Kosovës.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

Çmimi Vjetor për Vepër Shkencore “Zef Mirdita”

Ky Çmim u jepet autorëve për vepër shkencore në fushën e trashëgimisë kulturore.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë profesionistët, studiuesit dhe hulumtuesit në fushën e trashëgimisë kulturore, shtetas të Republikës së Kosovës dhe shtetas të vendeve të tjera.

Çmimi Vjetor për Menaxhim Institucional “Muhamed Shukriu”

Ky Çmim u jepet udhëheqësve të institucioneve dhe punonjësve të institucioneve publike dhe jopublike që në mandat kanë mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.

Laureatë të këtij çmimi mund të jenë udhëheqësit dhe punonjësit e institucioneve publike dhe jopublike të institucioneve të trashëgimisë kulturore shtetas të Republikës së Kosovës.

Vlerësimin për dhënien e çmimeve e bën juria profesionale.

Konkurrimi për Çmimet në fushën e trashëgimisë kulturore mund të bëhet përmes propozimit nga:

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës (për tri çmimet e para);

Institucionet e trashëgimisë kulturore;

Institutet shkencore, arkivat, muzetë;

Fakultetet e universiteteve publike si dhe private të Republikës së Kosovës;

Shoqatat dhe organizata që merren me trashëgimisë kulturore;

Personat fizikë dhe juridikë.

Propozimi duhet të përmbajë:

- Dokumentacion personal (kopje e dokumentit identifikues);
- Biografia me fokus në veprimtarinë për të cilin çmim nominohet;
- Dëshmitë relevante për kontributet e publikuara të të nominuarve (abstraktet e publikimeve nga fusha për të cilën nominohen, dëshmia dhe përmbajta e projekteve profesionale apo shkencore, vlerësimet dhe rekomandimet për kontribut në menaxhimin institucional në fushën për të cilën nominohet).

Propozimi duhet të nënshkruhet nga titullari që ka të drejtën e propozimit.

Propozimet me shkrim duhet të dërgohen deri me 3 Janar 2020 në adresën:
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit /Departamenti Trashëgimisë Kulturore,
Zyra Nr. 22 Adresa : Sheshi “ Nëna Terezë “ Nr. 35, Prishtinë

Rregulloren mund ta gjeni në web faqen e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit:
www.mkrs-ks.org

Nagrade iz oblasti kulturne baštine

Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta, u podudarnosti sa Pravilnikom e BR.09/2016 za Dodelu Nagrada iz oblasti kulturne baštine, objavljuje:

KONKURS

Za nagrade koje dodeljuje Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta iz oblasti kulturne baštine. Pozivaju se zainteresovani da predlože kandidate za Nagradu za Životno Delo iz oblasti kulturne baštine “Dea Dardanicae”, Godišnje Nagrade za Posebne Zasluge “Shtjefën Gjeçovi”, Godišnje Nagrade za Naučno Delo “Zef Mirdita” i Godišnje Nagrade za Institucionalno Upravljanje “Muhamed Shukriu”.

Nagrada za Životno Delo iz oblasti Kulturne Baštine “Dea Dardanicae”

Ova se nagrada dodeljuje istaknutim ličnostima, istaknutim profesionalcima, koji su, svojim stalnim angažovanjem imali direktan uticaj u unapređenju kulturne baštine kao i, podstakli dostignuća u zaštiti, očuvanju i promovisanju kulturne baštine Kosova.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Godišnja nagrada za Posebne Zasluge “Shtjefën Gjeçovi”

Ova se nagrada dodeljuje istaknutim ličnostima iz oblasti kulturne baštine, za angažovanje, doprinos i dostignuća tokom godine, za ispunjavanje ustavnih i zakonskih obaveza za zaštitu, očuvanje i promovisanje kulturne baštine Kosova.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Godišnja nagrada za Naučno delo “Zef Mirdita”

Ova se nagrada dodeljuje autorima za naučno delo iz oblasti kulturne baštine.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Godišnja nagrada za Institucionalno Upravljanje “Muhamed Shukriu”

Ova se nagrada dodeljuje rukovodiocima institucija i radnicima javnih institucija koji u svom mandatu imaju zaštitu, očuvanje i promovisanje kulturne baštine.

Laureati ove nagrade mogu biti profesionalci, naučnici i istraživači iz oblasti kulturne baštine, državljani Republike Kosova i državljani ostalih zemalja.

Procenjivanje o dodeli nagrada vrši profesionalan žiri.

Konkurisanje za Nagrade iz oblasti kulturne baštine mogu da se izvrše preko predlaganja od:

Akademije Nauke i Umetnosti Kosova (za tri prve nagrade);

Institucija kulturne baštine;

Naučnih Instituta, arhivat, muzeja;

Javnih fakulteta i univerziteta Republike Kosova;

Društava i organizacija koja se zauzimaju kulturnom baštinom;

Fizičkih i pravnih lica.

Predlog treba da sadrži:

- Ličnu dokumentaciju (kopija dokumenta za identifikovanje);
- Biografij sa fokusom na delatnosti za nagradu za koju se nominira;
- Relevantne dokaze za objavljene doprinose nominiranih (objavljeni abstrakti za oblast za koju se nominiraju, dokaz i sadržaj profesionalnih ili naučnih projekata, ocenjivanja i preporuke za institucionalno upravljanje iz oblasti za koju se nominira).

Predlog treba da se potpiše od titulara koji ima pravo na predlaganje.

Pismeni predlozi mogu da se pošalju do 3 Januara 2020 na adresu:
Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta /Departman Kulturne Baštine,
kancelarija br. 22 Adresa : Trg “ Majke Tereze “ br. 35, Priština

Pravilnik u web stranici Ministarstva, Kulture, Omladine i Sporta
www.mkrs-ks.org


TrafikuUrban

K O N K U R S

Pozita e punës: Zyrtar për IT (Teknologji Informativ) -I pozitë;

Kohëzgjatja e kontratës: 3 vite, me mundësi vazhdimi;

Orari i punës: I plotë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Ofrimi i shërbimeve dhe menaxhimi i pajisjeve të teknologjisë së informacionit për të krijuar një sistem funksional në përputhje me nevojat dhe kërkesat e ndërmarrjes
- Përgatitja e kërkesave të shfrytëzuesve dhe specifikacioneve tjera teknike;
- Kujdeset për montimin e pajisjeve të teknologjisë informativë përfshirë kompjuter, printer, skaner dhe pajisje tjera;
- Ndihmon personelin e ndërmarrjes në përdorimin e pajisjeve të teknologjisë informativë, aplikacioneve dhe bazave të dhënave dhe kryen aktivitete tjera me qëllim për t'iu ofruar gjithë personelit qasje të lehtë në sistemin e teknologjisë informativë;
- Instalton kompjuterët me sisteme operative Windows, Office dhe softuer tjetër sipas nevojës duke u kujdesur për ruajtjen e shënimeve;
- Ndihmon në rregullimin dhe monitorimin e masave përforcuese të programeve softuerike dhe shërbimet ndihmëse.
- Për punën e tij/saj i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv.

Përgatitja profesionale:

-Diplomë Universitare - Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe Teknologji Informativë;

Shkathtësitë

- Shkathtësi në komunikim, planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit.
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- Njohuri të mira të programeve kompjuterike;
- Njohja e programit "Bilanc" (përparësi);

Dokumentacioni i kërkuar:

Kandidati/ja, duhet t'i dorëzojë këto dokumente në formë të skanuar në email: punesimi@trafikurban-pr.com:

1. Aplikacioni për punësim (shkarkohet nga web-faqja e TU-së <http://www.trafikurban-pr.com/shq/job-aplikacioni-shq.html>;
2. Dëshmi mbi shkollimi;
3. Kopja e letërnjoftimit;
4. Certifikata tjera (përparësi).

-Çdo përgënjeshtrim i materialit, qoftë i qëllimshëm ose nga neglizhenca ose ndryshim material nga informatat e dhëna në deklaratën e sipër cekur do të rezultojë në skualifikimin e menjëhershëm.

Informata të përgjithshme:

- Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjitha qytetarët pa dallim.
- Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjesëtarë të të gjitha komuniteteve dhe të gjinive të ndryshme.
- Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi mund të bëhet vetëm përmes emailit : punesimi@trafikurban-pr.com

Konkursi është i hapur nga data **07.12.2019** dhe përfundon më datë **23.12.2019** në ora 24:00

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara dhe të pa nënshkruara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

NPK "Trafiku Urban" SHA

Adresa: Rr. Tahir Zajmi, nr. 43 – Prishtinë - Kosovë

web: www.trafikurban-pr.com email: info@trafikurban-pr.com tel: +383 (0) 45 10 11 23

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Albulena Brestovci shpall të pavlefshme diplomën e Masterit të Kolegjit AAB-Prishtinë me nr. 635/18.

► Behar Ahmeti shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore (kl I-IX) "Enver Haliti" Lubovec.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vívës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira në qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, në lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroi i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar të salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.

► Lëshohet me qira banesa në lagjen Bregu i Diellit te furra Qërimi 2. Banesa është në katin e tretë, ka sallon dhe kuzhinë si dhe dy dhoma të fjetjes. Numri i telefonit: 044 332 640.

► Lëshohet banesa me qira në Prishtinë në lagjen "Ulpiana", afër AAK-së. Për informata lajmërohuni në tel: 044/162-783

► Lëshoj banesë me qira në Ulpianë, tek Fontana në: E 30-3A, nr.27, kati -IV-. Çmimi sipas marrëveshjes në info: 044-132-368.

► Kërkoj dy bashkëbanuese, mundësisht të cilat janë duke punuar. Banesa gjendet në qendër të qytetit në Prishtinë përball Prokurorisë së shtetit (ish-ndërtesa e OSBE-së, ose ish-ndërtesa e Bankës së Lubjanës), rruga "Hajdar Dushi", afër shtabit kryesor të Policisë së Kosovës. Banesën mund ta shihni çdo ditë. Numri i telefonit: 049/402-518.

► Shesim banesën dy dhomshe në Ulpiana D8 h3 Nr 15 kati 3 ndërtim i vjetër, e rinovuar komplet, me nxemje të qytetit, çmimi 77 000€. Informatat tel:049/400-958 dhe 044/627-387

► Lëshoj banesën e pamobiluar (garsonierë) me qira. Banesa, e cila gjendet rrugës për në Gërmë, 150 metra afër Kolegjit Amerikan A.U.K, ndodhet në katin 5. Çmimi 130 euro. Tel: 049/705-503 dhe 049/662-211.

► Lëshoj garsonierën me qira 13 m2 kati i IV (katër) në Lagjen Ulpiana. Çmimi 150 euro. Për info: 044/637-546.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Ulpiana objekti C7 kati i 3 hyrja e II-të nr 11 ka 50 m2 dy dhomshe, një banjo, kuzhinë të gjitha të reja, është e përshtatshme për zyre edhe apo ordinancë. Për informata nr tel; 044/641-524 dhe + 46705793508.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

